



## RAPORT VJETOR 2023

Vendimi: Nr. I/33

Bordi i Drejtorëve i HK-Trainkos Sh.A, në Mbledhjen Nr. 04, të mbajtur më datë 29.02.2024, njëzëri miratoi Raportin Vjetor për vitin 2023.

	Delegoi	Aprovoi
<b>Emri Mbiemri:</b>	<b>Agron STATOVCI</b> U.D Kryeshef Ekzekutiv	<b>Jetmir NUKA</b> Kryesuesi i BD
<b>Nënshkrimi:</b>		
<b>Data:</b>	14.02.2024	 29.02.2024



# **RAPORT VJETOR 2023**

**Fushë Kosovë,  
Shkurt 2024**

## PËRMBAJTJA

<b>I.</b>	<b>HYRJJE.....</b>	<b>4</b>
<b>II.</b>	<b>RAPORT I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE .....</b>	<b>5</b>
II.1.	Aktivitetet dhe performanca e Ndërmarrjes.....	6
II.2.	Informacione lidhur me kapitalin dhe dividenden.....	9
II.3.	Të dhënat për drejtorët joekzekutivë.....	10
II.4.	Komitetet e Bordit të Drejtorëve .....	11
<b>III.</b>	<b>FJALA E KRYESHEFIT EKZEKUTIV.....</b>	<b>12</b>
III.1	Ngjarjet kryesore të vitit.....	13
<b>IV.</b>	<b>PASQYRA E PERFORMANCËS OPERATIVE.....</b>	<b>14</b>
IV.1.	Transporti i mallrave.....	14
IV.2.	Transporti i udhëtarëve.....	18
IV.3.	Mirëmbajtja e mjeteve lëvizëse.....	21
<b>V.</b>	<b>PASQYRA E PERFORMANCËS FINANCIARE DHE REZULTATET..</b>	<b>24</b>
V.1.	Gjendja financiare .....	24
V.1.1.	Të hyrat.....	24
V.1.2.	Shpenzimet.....	25
V.1.3.	Të hyrat dhe shpenzimet operative .....	26
V.2.	Gjendja në para të gatshme – Raporti sipas Bankës (31.12.2023).....	28
V.3.	Transaksionet e realizuara.....	29
V.4.	Bilanci i gjendjes .....	30
<b>VI.</b>	<b>PROJEKTET KAPITALE.....</b>	<b>31</b>
<b>VII.</b>	<b>AKTIVITETET NË PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E BIZNESIT..</b>	<b>33</b>
VII.1.	Planifikimi dhe zhvillimi i biznesit.....	33
VII.2.	Koordinimi i proceseve me MMPHI, ARH dhe institucionet tjera relevante.....	35
VII.3.	Aktivitetet e marketingut.....	40
VII.4.	Raportimi i rregullt vjetor në Asociacionet tjera Hekurudhore dhe Sekretariatit për Zbatimin e Traktatit për Transport.....	41
VII.5.	Shqyrtimi i mundësive për kryerjen e veprimtarisë – Shpedicion për klientët.....	41
VII.6.	Sfidat kryesore gjatë vitit 2023 dhe veprimet për të ardhmen.....	42
<b>VIII.</b>	<b>STRUKTURA ORGANIZATIVE.....</b>	<b>43</b>
<b>IX.</b>	<b>PROCEDURAT GJYQËSORE.....</b>	<b>45</b>
IX.1.	Kontestet gjyqësore.....	45
IX.2.	Rreziqet nga kontestet gjyqësore për vitin 2024.....	45
<b>X.</b>	<b>PËRFUNDIM.....</b>	<b>46</b>
<b>I.</b>	<b>ANEKS RAPORTI</b>	
<b>I.1</b>	Raport lidhur me sponsorizimet dhe donacionet	
<b>I.2</b>	Raport Vjetor i Zyrës së Auditimit të Brendshëm për vitin 2023	

## I. HYRJE

Na lejoni të ju prezantojmë Raportin Vjetor të Hekurudhave të Kosovës-Trainkos Sh.A. për vitin 2023 dhe të ndajmë me ju të arriturat dhe sfidat, të cilat ndërmarrja i kishte në vitin të cilin e lamë pas, si dhe njëherit të falënderojmë Qeverinë dhe Donatorët, për mbështetjen si dhe të gjithë ata që janë përkushtuar për një të ardhme më të qëndrueshme të ndërmarrjes.

Gjatë vitit 2023, ndërmarrja kishte një ecuri progresive drejt realizimit të planit operativ dhe financiar, por edhe sfidat ishin të mëdha. Funksionimi i ndërmarrjes, përkatësisht ofrimi i shërbimeve të saj më esenciale në transportin hekurudhor të mallrave dhe udhëtarëve ishin ndikuar nga vonesat në realizimin e projektit për Modernizimin e Linjës së 10-të Hekurudhore. Mospërfundimi i realizimit të këtij projekti kishte ndikuar në ndërprerjen e plotë të transportit në Linjën e Hanit të Elezit, si dhe në realizimin e disa projekteve dhe në përgjithësi në arritjen e objektivave të ndërmarrjes për vitin 2023. Mirëpo, përkundër kësaj, falë përkushtimit dhe angazhimit të tërë ekipit të HK-Trainkos Sh.A. është arritur që ndërmarrja të ketë disa rezultate dhe të ruajë likuiditetin e saj.

Raporti është i ndarë në disa kapituj, ku pasqyrohen aktivitetet e ndërmarrjes rezultatet e punës dhe sfidat në arritjen e rezultateve si dhe synimin që të vazhdoj të jetë e përkushtuar në ngritjen e cilësisë së shërbimeve, në përmbushje të mandateve që dalin sipas legjislacionit në fuqi.

Raporti është ndërtuar sipas kërkesave ligjore dhe udhëzimeve të Aksionarit si dhe i njëjti ofron informacione në lidhje me kapitalin e ndërmarrjes, politikat që ndikojnë në zhvillimin e biznesit si dhe të dhënat tjera për strukturën dhe angazhimet e Bordit. Me qëllim të një prezantimi më të saktë pjesë e tij janë edhe grafikonet, tabela statistikore si dhe skema tjera me sqarime të nevojshme.

Pjesë e raportit vjetor është edhe Aneksi 1, i cili përmban të dhëna tjera shtesë të cilat mbesin për përdorim të Aksionarit. Në këtë pjesë janë përfshirë raporti lidhur me sponzorizimet dhe donacionet si dhe Raport Vjetor i Zyrës së Auditimit të Brendshëm. Ndërsa, sa i përket Raportit të Vetëvlerësimit të Bordit të Drejtorëve, ai nuk do të jetë pjesë e këtij raporti për shkak se Bordi aktual nuk ka qenë i angazhuar gjatë vitit 2023.

Misioni i ndërmarrjes është që me gatishmëri të përhershme në plotësimin e kërkesave të klientëve dhe shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve duke aplikuar teknologji të standardizuara me punonjës të trajnuar dhe motivuar. Andaj, ky mision konsiderohet i rëndësishëm për ne, kështu që, edhe synimi dhe interesi ynë është që transporti hekurudhor të zhvillohet krahas standardeve ndërkombëtare.

Përmes këtij raporti vlerësojmë se kemi ofruar informacione rreth angazhimeve tona, dhe zotohemi se edhe në të ardhmen do të vazhdojmë të angazhohemi me përkushtim në tejkalimin e sfidave aktuale, arritjen e objektivave dhe për një të ardhme më të qëndrueshme të HK-Trainkos Sh.A.

## II. RAPORT I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE

### **Të nderuar aksionarë,**

Bazuar në të dhënat e ndërmarrjes, përkundër përpjekjeve të Bordit dhe stafit shihet se ndërmarrja edhe gjatë vitit 2023 është ballafaquar me vështirësi e sfida të shumta, të cilat kanë qenë ndikuese në realizimin e planifikimeve operative e financiare. Problemet e trashëguara ndër vite sa janë rritur e bartur në këtë periudhë dhe zgjidhja e tyre do të jetë tejet sfiduese për të gjithë ne.

Ne, Bordi i Drejtorëve, i emëruar në fillim të vitit 2024, duke parë gjendjen dhe rrethanat në ndërmarrje, kemi ndërmarrë hapa konkret në drejtim të tejkalimit dhe të zgjidhjes së problemeve. Si mundësi, dhe nevojë paraprake, për të ndryshuar gjendjen ekzistuese, është vlerësuar hartimi i një plani strategjik afatmesëm, për të cilin veç jemi në hapat e parë të hartimit të tij.

Gjithashtu, ne do të ushtrojmë kompetencat tona në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve sipas Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjit Nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, po ashtu edhe obligimet tjera që dalin nga ligjet tjera të aplikueshme për NP.

Angazhimi ynë në hartimin e politikave dhe dokumenteve tjera strategjike për ndërmarrjen si dhe mbikëqyrja e vazhdueshme në zbatimin e tyre do të jetë angazhimi ynë i përditshëm për një qeverisje korporative sipas standardeve më të larta.

Gjendja e vështirë e ndërmarrjes nga mosrealizimi operativ e financiar dhe nga humbjet e larta të shkaktuara vite më radhë, shihet se në vitin 2023 ka pasur efikasitet operacional dhe përmirësim të vogël të gjendjes financiare.

## II.1. AKTIVITETET DHE PERFORMANCA E NDËRMARRJES

Aktivitetet kryesore gjatë vitit 2023 kanë qenë në drejtim të realizimit të objektivave të planifikuara si dhe në drejtim të tejkalimit të pengesave dhe vështirësive tjera të ndërmarrjes.

Sfidat me të cilat është ballafaquar HK-Trainkos Sh.A gjatë kësaj periudhe raportuese ishin në përgjithësi nga gjendja e rëndë financiare, e cila vazhdon edhe sot të jetë e tillë.

Gjithashtu, ndërprerjet e transportit hekurudhor nga punimet që janë duku u zhvilluar në rehabilitimin e Linjës së 10-të Hekurudhore kanë paralizuar në tërësi transportin ndërkombëtar të mallrave dhe të udhëtarëve. Sa i përket transportit vendor të mallrave, vitin e kaluar është transportuar për NewCo Ferronikeli-n vetëm në një periudhe tremujore. Në transportin vendor të udhëtarëve gjatë vitit 2023 është mbajtur në operim vetëm Linja e Pejës me katër trena në ditë, dy në shkuarje dhe dy në ardhje.

Borxhet e akumuluar ndër vite, si në raport me partnerët ashtu edhe me institucionet tjera veç sa i shtohen listës së sfidave të ndërmarrjes. Për të gjitha problemet e theksuara, Bordi i Drejtorëve do të angazhohet që të gjej zgjidhje dhe të dalë nga kjo situatë.

Aktivitetet dhe angazhimet tjera, gjatë vitit 2023 kanë qenë edhe në drejtime tjera, si në angazhimin në përmbushjen e rekomandimeve të auditorëve për të gjeturat nga auditimi i vitit paraprak, ashtu edhe në përgatitjen dhe hartimin e dokumenteve strategjike e politikave tjera, mbi bazën e të cilave zhvillohet aktiviteti i Hekurudhave të Kosovës-Trainkos Sh.A.

### **Aktivitetet kryesore të ndërmarra gjatë vitit 2023**

Përkushtimi kryesor gjatë vitit 2023 ka qenë arritja e caqeve të përcaktuara në Planin e Biznesit për këtë vit. Mirëpo, ndërmarrja, për arsytet që u theksuan, përsëri nuk ka arritur objektivat e planifikuara, por ka një performancë dukshëm më të mirë krahasuar me vitin paraprak.

Në funksion të arritjes së objektivave dhe me qëllim të përmirësimit të gjendjes, në bazë të raporteve shihet se janë ndërmarrë masa dhe veprime në tejkalimin dhe zgjidhjen e pengesave të shfaqura.

Me Menaxherin e Infrastrukturës janë mbajtur takime e zhvilluar kontakte të shumta për të ndikuar që Linja e Hanit të Elezit të jetë në funksion edhe gjatë punimeve në këtë Linjë sipas një orari të përshtatshëm për qarkullimin e trenave.

Hartimi dhe rishikimi i politikave të ndërmarrjes ka vazhduar edhe gjatë vitit 2023, të cilat definojnë procedura e çështje të brendshme të organizimit të punëve, të cilat kanë pasur efekte pozitive. Bashkëpunimi me institucionet vendore e ndërkombëtare gjithashtu ka qenë në fokus të angazhimit dhe nuk kanë munguar përpjekjet në këtë drejtim.

## **Pasqyra e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitin paraprak dhe planin e vitit aktual**

Gjatë vitit 2023 Hekurudhat e Kosovës-Trainkos Sh.A. kanë pasur një rezultat jo të kënaqshëm operativ e financiar. Krahasuar me vitin paraprak është shënuar rritje e realizimit, mirëpo objektivat e planifikuara për vitin 2023 nuk janë arritur plotësisht.

Realizimi operativ e financiar në transportin e udhëtarëve ka qenë më afër objektivave të planifikuara, ndërsa krahasuar me realizimin e vitit paraprak ka pasur një rënie të vogël. Te transporti i mallrave realizimi operativ e financiar, krahasuar me planifikimin ka qenë më larg realizimit, mirëpo krahasuar me realizimin nga viti paraprak, ka qenë në shkallë shumë më të lartë të realizimit.

### **Transporti i Mallrave**

Performanca operative në transportin e mallrave gjatë vitit 2023, krahasuar me planifikimin është realizuar në shkallën prej 34.02%, ndërsa krahasuar me realizimin e vitit paraprak realizimi ka qenë për 875.87% më i lartë. Sa i përket performancës financiare nga transporti i mallrave, ajo është realizuar në shkallën 32.17% të planifikimit.

### **Transporti i Udhëtarëve**

Performanca operative në transportin e udhëtarëve gjatë vitit 2023, krahasuar me planifikimin është realizuar në shkallën prej 88.15%, ndërsa krahasuar me realizimin e vitit paraprak realizimi ka qenë për 1.64% më i ulët. Vlen të theksohet se numri i udhëtarëve është edhe më i lartë, mirëpo nuk është vendosur ndonjë mekanizëm që do të përcaktonte edhe numrin e udhëtarëve që janë të liruar nga pagesa.

### **Ngjarjet të cilat ndikojnë në të ardhmen e Ndërmarrjes**

Një ndër sfidat kryesore për Ndërmarrjen HK-Trainkos Sh.A. mbetet modernizimi i parkut të mjeteve lëvizëse duke pasur parasysh numrin e vogël të këtyre mjeteve që kemi në dispozicion por edhe vjetërsinë e tyre, të cilat përveç shpenzimeve të larta për mirëmbajtje kanë edhe shpenzime tjera operuese, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e kostos se përgjithshme.

Vlen të theksohet se kjo gjendje e mjeteve lëvizëse që kemi në parkun tonë është si rezultat i buxhetit të vogël që ka Ndërmarrja HK-Trainkos Sh.A.

Fillimi i investimeve në modernizimin e rrjetit hekurudhor është shumë më rëndësi për zhvillimin hekurudhor, por nga kjo kërkohet që investimet të shtohen edhe në modernizimin e mjeteve lëvizëse të HK-Trainkos Sh.A.

Po ashtu, sfidë e vazhdueshme mbetet përpilimi dhe hartimi i politikave strategjike për zhvillim

të ndërmarrjes. Në këtë kontekst, BD është i përkushtuar të ndërmarrë nismat që janë në përgjegjësi të tij, që projekteve t'u japë shtytje për realizim.

Gjithashtu, vlen të theksohet se shërbimet e veçanta që ofrojmë kërkojnë edhe përgatitje profesionale të veçantë. Andaj, fokus i angazhimeve tona do të jetë në përgatitjen e kuadrove, qoftë përmes ndonjë iniciative për hapje të drejtimeve shkollore përkatëse në Kosovë, apo edhe përmes trajnimit dhe certifikimit.

### **Të priturat për vitin e ardhshëm**

Një prej synimeve tona, padyshim që është planifikimi i investimeve në modernizimin e mjeteve lëvizëse apo edhe në blerjen e mjeteve të reja. Për këtë jemi të vetëdijshëm se është një mision i vështirë, por me ndihmën e Aksionarit, pa lënë anash edhe mundësinë për gjetjen e donatorëve apo formave tjera për investim shpresojmë se do t'ia dalim.

Për këtë qëllim, gjatë këtij viti do të angazhohemi në hartimin e një plani strategjik-investiv, duke u bazuar edhe në Strategjinë e Transportit Multimodal, në të cilin planifikohet që krahas me zhvillimet në infrastrukturën hekurudhore të bëhen edhe investimet në mjetet lëvizëse.

Sfidat me të cilat ballafaqohemi, vitin e ardhshëm do të jenë ndikuese edhe në arritjen e objektivave të parapara në planin e biznesit për vitin 2024. Problemet e ndërprerjes së transportit për shkak të punimeve që janë duke u zhvilluar në Linjën e 10-të Hekurudhore do të jenë çështja më sfiduese për zhvillimin e punës dhe të projekteve të ndërmarrjes.



## **II.2. INFORMACIONE LIDHUR ME KAPITALIN DHE DIVIDENTEN**

Gjatë vitit 2023, ndërmarrja ka zhvilluar procedurat për projektet kapitale, përkatësisht procedurat për realizimin e tyre, mirëpo nuk është arritur që ato të realizohen për shkak të buxhetit të kufizuar dhe për shkak të pengesave të shfaqura nga punimet në rehabilitimin e Linjës së 10-të Hekurudhore.

Gjatë vitit 2023, ndërmarrja ka pranuar në donacion nga Hekurudhat e Zvicrës, pajisje për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse në vlerë doganore 9,052.5€.

Ndërsa, sa i përket shpërndarjes së dividendës, ndërmarrja nuk ka arritur atë nivel të realizimit (fitimit) për ta ndarë atë ashtu siç është e paraparë me aktet juridike të cilat rregullojnë këtë çështje.

## II.3. TË DHËNAT PËR DREJTORËT JOEKZEKUTIVË

Në pjesën në vijim të këtij raporti pasqyrohen të dhënat për drejtorët joekzekutivë që kanë qenë të angazhuar në ndërmarrje gjatë vitit 2023, përfshirë edhe pjesëmarrjen e tyre në mbledhjet e mbajtura. Është e rëndësishme të theksohet se gjatë këtij viti ka pasur ndryshime të theksuara në strukturën dhe në vetë Bordin e Drejtorëve. Përderisa disa prej drejtorëve të Bordit, të emëruar me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 03/92, të datës 10.08.2022, kishin dhënë dorëheqje nga pozita, më 12.04.2023 Qeveria ka emëruar Bordin e Përkohshëm të Drejtorëve, i cili ka funksionuar deri më 12.10.2023, ndërsa pas kësaj date ndërmarrja ka funksionuar pa Bord, deri në fillim të vitit 2024.

Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 15/138, të datës 12.04.2023, ka emëruar Bordin Përkohshëm të Drejtorëve të HK-Trainkos Sh.A, andaj të dhënat për drejtorët joekzekutivë, në këtë pjesë të raportit, do të pasqyrohen edhe për Bordin e Drejtorëve që ka funksionuar deri më 12.04.2023.

Gjatë vitit 2023 janë mbajtur gjithsejtë trembëdhjetë (13) mbledhje të Bordit të Drejtorëve, katër (4) prej tyre janë mbajtur deri më datën 12.04.2023 dhe nëntë (9) mbledhje tjera janë mbajtur pas kësaj date, duke llogaritur edhe Mbledhjen e Kuvendit Vjetor të Aksionarëve.

Në pjesën në vijim do të pasqyrohen të dhënat për strukturën dhe mbledhjet e Bordit të Drejtorëve për vitin 2023.

### Të dhënat për mbledhjet e Bordit të Drejtorëve nga data 01.01.2023 deri më 12.04.2023:

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Pozita	Pjesëmarrja në mbledhje
1	Nol Dedaj	Kryesues	3
2	Astrit Mehaj	Anëtar	4
3	Drita Kadriu-Berisha	Anëtar	2
4	Blerina Shamolli	Anëtar	1
5	Riza Spanca	Anëtar	3
6	Shaban Neziri	Anëtar	4
7	Gelor Shala	Kryeshef Ekzekutiv	3
8	Naim Neziri	Zëvendëskryeshef	1
9	Afrim Kuleta	Sekretar	4

### Të dhënat për mbledhjet e Bordit të Drejtorëve nga data 12.04.2023 deri më 12.10.2023:

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Pozita	Pjesëmarrja në mbledhje
1	Riza Spanca	Kryesues	9
2	Astrit Mehaj	Anëtar	8
3	Shaban Neziri	Anëtar	7
4	Hasan Preteni	Anëtar	9
5	Agron Statovci	U.D. Kryeshef Ekzekutiv	9
6	Afrim Kuleta	Sekretar	9

## II.4. KOMITETET E BORDIT TË DREJTORËVE

Gjatë vitit 2023 Bordi nuk ka formuar komitete, ato planifikohen të formohen gjatë vitit 2024. Mirëpo, me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore dhe arritjes së performancës së ndërmarrjes, punën e Bordit të Drejtorëve e ka ndihmuar Komisioni i Auditimit, i cili është formuar nga Aksionari. Kontributi i Komisionit të Auditimit ka qenë tejet i rëndësishëm në definimin e shumë çështjeve dhe lehtësimin e punëve të Bordit.

Gjatë vitit 2023, përkatësisht deri më 12.04.2023, përbërja e Komisionit të Auditimit ka qenë sipas Vendimit të ME-së Nr. 01/1909, të datës 15.08.2022, ndërsa pas datës 12.04.2023 përbërja e Komisionit të Auditimit ka qenë sipas Vendimit të ME-së Nr. 01/1313, të datës 14.04.2023. Në pjesën në vijim të këtij raporti paraqesim të dhënat për përbërjen e Komisionit, kohën e funksionimit dhe mbledhjet e mbajtura gjatë vitit 2023.

Gjatë vitit 2023 janë mbajtur gjithsejtë nëntë (9) mbledhje të Komisionit të Auditimit, tri (3) prej tyre janë mbajtur deri më datën 12.04.2023 dhe gjashtë (6) mbledhje tjera janë mbajtur pas kësaj date.

### Të dhënat për mbledhjet e Komisionit të Auditimit nga data 01.01.2023 deri më 12.04.2023:

Komiteti (koha e funksionimit)	Emri dhe Mbiemri	Pozita	Pjesëmarrja në mbledhje
<b>KOMISIONI I AUDITIMIT</b> 12.10.2022 – 12.04.2023	1 Riza Spanca	Kryesues	3
	2 Drita Kadriu-Berisha	Anëtare	2
	3 Astrit Mehaj	Anëtar	3

### Të dhënat për mbledhjet e Komisionit të Auditimit nga data 12.04.2023 deri më 12.10.2023:

Komiteti (koha e funksionimit)	Emri dhe Mbiemri	Pozita	Pjesëmarrja në mbledhje
<b>KOMISIONI I AUDITIMIT</b> 12.04.2023 – 12.10.2023	1 Astrit Mehaj	Kryesues	6
	2 Hasan Preteni	Anëtar	6
	3 Shaban Neziri	Anëtar	6

I nderuari Aksionar, të nderuar klientë dhe ju punonjës të përkushtuar, shpreh vlerësimin tim të thellë për bashkëpunimin, mbështetjen dhe angazhimin në punën tonë të përbashkët!

Besimi, mbështetja dhe puna juaj e palodhur janë shtyllat e suksesit të Ndërmarrjes HK-Trainkos Sh.A.!

Së bashku, ne kemi krijuar një histori të mirë deri më tani, dhe jam i bindur se kapitujt më të mirë nuk janë shkruar ende.

Faleminderit për besimin e vazhdueshëm në HK-Trainkos Sh.A.!

**Në emër të Bordit të Drejtorëve të HK-Trainkos Sh.A.**

**Jetmir NUKA – Kryesues**

### III. FJALA E KRYESHEFIT EKZEKUTIV

Ndërmarrja HK-Trainkos Sh.A. vitin 2023 arriti që ta përmbyll me rezultate jo të mira por të kënaqshme krahasuar me vitin paraprak, duke marr për bazë ndikimin e shumë faktorëve të ndryshëm si: ndërprerja e plotë e linjës hekurudhore Fushë Kosovë – Hani i Elezit nga shkak i punimeve në realizimin e projektit “Modernizimi i Linjës së 10-të Hekurudhore” si dhe ndërprerja e transportit vendor të mallrave nga klienti ynë NewCo Ferronikeli.

Nga ndikimi i faktorëve që u theksuan më lart, gjatë vitit 2023 ndërmarrjes i janë shkaktuar probleme të mëdha, sidomos në mosrealizimin e planifikimeve të deklaruara nga ana e bashkëpunëtorëve (klientëve) tanë. Këta faktorë kanë pasur ndikim direkt në (mos) përmbushjen e parashikimeve sipas Planit të Biznesit, e sidomos me paraqitjen e krizës energjetike ku klienti/operatori ynë NewCo Feronikeli ndërpreu punën.

Sa i përket realizimit të detyrave dhe respektimit të afateve ligjore të raportimit, ndërmarrja ka arritur që këto obligime t’i përmbush me sukses. Trainkos Sh.A. me kohë ka hartuar Planin e Biznesit, është pajisur me licencat e nevojshme operuese nga Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH) dhe në vazhdimësi ka raportuar tek Aksionari mbi gjendjen dhe zhvillimet në ndërmarrje.

Puna dinamike në funksion të përshtatshmërisë të rregulloreve të brendshme me legjislacionin në fuqi ka vazhduar edhe gjatë vitit 2023, po ashtu është trajtuar edhe aspekti i përshtatshmërisë me direktivat e Bashkimit Evropian dhe rregullave ndërkombëtare të operimeve në transportin hekurudhor.

Vazhdojnë të mbetën sfidë fondet e pamjaftueshme për investime kapitale në modernizimin dhe rritjen e flotës operuese, mjetet me të cilat operojmë janë të vjetra dhe si rrjedhojë krijojnë edhe shpenzime të mëdha.

Aktualisht transporti hekurudhor ndërkombëtar është plotësisht i ndërprerë, përderisa në linjën ndërkombëtare përmes Maqedonisë së Veriut, transporti është ndërprerë nga punimet që janë duke u zhvilluar në realizimin e projektit “Modernizimi i Linjës së 10-të Hekurudhore”, transporti ndërkombëtar përmes kufirit në veri qëndron i mbyllur për arsye të njohura politike. Pamundësia e zhvillimit të transportit ndërkombëtar ka ndikuar në performancën e ndërmarrjes dhe ka ndikuar që shumë klientë potencialë të orientojnë transportin e tyre përmes alternativave tjera.

Për të tejkaluar pengesat e shfaqura dhe për të arritur objektivat e përcaktuara, angazhimi ynë do të jetë me fokus të veçantë në investime të vazhdueshme, të cilat do të kenë ndikim në uljen e shpenzimeve, përmirësim koherent të shërbimit dhe në drejtim të zhvillimit të vazhdueshëm të ofertës dhe rritjes së efikasitetit të strukturës organizative.

**U.D Kryeshef Ekzekutiv  
Agron STATOVCI**

### III.1. NGJARJET KRYESORE TË VITIT

Ngjarjet kryesore më rëndësi të veçantë që e kanë shoqëruar Trainkos-in gjatë vitit 2023 janë të paraqitura si në vijim:

1. Nga ARH, më 22.08.2023 kemi pranuar informatën se përfaqësuesit nga European Union Agency for Railways-ERA, kanë njoftuar që Drejtori Ekzekutiv i ERA-së, Dr. Josef Doppelbauer ka vendosur më 21 qershor 2023 që Kosova do të jetë në gjendje të përdorë Kodin numerik dyshifror "00" për të gjitha shtetet/territoret e tjera përkohësisht derisa të gjendet një zgjidhje përfundimtare.
2. Pjesëmarrja aktive në punëtoritë të organizuar nga Sekretariati për zbatimin e Traktatit për Transport, që reflekton në përmirësimin e aktiviteteve të ndërmarrjes si pjesë përbërëse e sistemit hekurudhor dhe përshtatjen e reformave të domosdoshme për të qenë pjesë integruese e sistemit Evropian për transportin e udhëtarëve dhe mallrave. Me avancimin e proceseve përfitojnë udhëtarët që shfrytëzojnë transportin me hekurudhë dhe bizneset për transportin e mallrave në dhe nga Republika e Kosovës;
3. Ndërmarrja HK-Trainkos Sh,A në kuadër të aktivitetit “Muaji i Rinisë”, me kërkesë të Ministrisë së Ekonomisë dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, më datë 24.08.2023, ka realizuar udhëtimin me tren në relacionin Prishtinë – Pejë – Prishtinë me trenat e rregullt 4201/4200.
4. Bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë dhe mbështetja në fushatën globale “16 Ditët e Aktivizmit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore”
5. Bashkëpunimi rajonal në fushën e transportit hekurudhor është i domosdoshëm. Aktualisht veprohet në forma bashkëpunimi sipas qasjes politike të shteteve të rajonit dhe vullnetit të kompanive hekurudhore veç e veç. Realizimi i iniciativës së filluar që nga muaji Shkurt 2016 për Marrëveshje gjithëpërfshirëse të procedurave kufitare me Republikën e Maqedonisë është diskutuar dhe priten rezultate. Përfitues janë shfrytëzuesit e transportit hekurudhor, por edhe shteti jonë që me zhvillimin më të lehtë hekurudhor krijon parakushte për transport të sigurt dhe heqjen e mbingarkesave nga rrugët e porsandërtuara anekënd Republikës së Kosovës.

## IV. PASQYRA E PERFORMANCËS OPERATIVE

Në këtë pjesë të raportit do të paraqesim indikatorët fizikë të performancës operative në transportin e mallrave dhe të udhëtarëve për periudhën dymbëdhjetë mujore, nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2023, si dhe do të behët krahasimi me planifikimin që është bërë për të njëjtën periudhë me planin e Biznesit të vitit 2023 si dhe duke krahasuar me realizimin e vitit paraprak 2022.

### IV.1. TRANSPORTI I MALLRAVE

Në pjesën në vijim të këtij raporti paraqesim në formë tabelore dhe përmes diagrameve performancën operative dhe financiare në transportin e mallrave për vitin 2023 si dhe të dhënat krahasuese me realizimin e vitit të kaluar, si dhe me planifikimin për vitin 2023.

Realizimi në transportin e mallrave 2023:

Përshkrimi	Sasia e transportuar Janar – Dhjetor 2023
Realizimi Neto Ton në 2022	22,340.07 Ton
Realizimi Neto Ton në 2023	195,670.51 Ton
Planifikimi Neto Ton në 2023	575,000.00 Ton
Dallimi: Realizim 2023 – Realizim 2022	173,330.44 Ton
Dallimi: Realizim – Planifikim në 2023	379,329.49 Ton
Dallimi: Realizim 2023 – Realizim 2022 (%)	875.87 %
Dallimi: Realizim 2023 – Planifikim 2023 (%)	34.02 %

Tabela 4.1.1


Siç mund të shihet nga tabela më lart, gjatë vitit 2023 kemi transportuar rreth 65.98% më pak sesa sasia e planifikuar për këtë periudhë dhe 875.8% më shumë sesa në vitin e kaluar 2022.

Transporti i mallrave me kontejnerë gjatë vitit 2023 ka qenë:

Përshkrimi	Numri i Transportuar i Kontejnerëve (Janar – Dhjetor 2023)
Kontejnerë të plotë – 2023	00.00 copë
Kontejnerë të plotë/zbrazët - 2023	00.00 copë

Tabela 4.1.2

### Sasia e transportuar në Neto ton për vitin 2023



**Figura 4.1.1**

Siç mund të shihet nga figura më lart në aspektin operativ kemi arritur të realizojmë 7.12% nga planifikimi i Planit të Biznesit për vitin 2023.

Të hyrat nga transporti i mallrave për periudhën raportuese janë:

Përshkrimi	Të hyrat për periudhën (Janar - Dhjetor 2023)
Realizim shitje të hyra 2022	145,584.27
Realizim shitje të hyra 2023	466,594.48
Planifikimi 2023	1,450,000.00
Realizim 2023 - Realizim 2022	321,010.21
Realizim – Planifikim 2023	-983,405.52
Realizim 2023 - Realizim 2022 (%)	320.49%
Realizim – Planifikim 2023 (%)	32.17%

**Tabela 4.1.3**

Siç mund të shihet nga tabela më lart të hyrat nga transporti i mallrave janë realizuar në shkallën prej 32.17% të planifikimit për vitin 2023.

### Të hyrat në periudhën vjetore 2023




Figura 4.1.2

### Të hyrat dhe shpenzimet nga transporti i mallrave:

Përshkrimi	Të hyrat dhe shpenzimet €
Shitjet nga transporti i mallrave	466,594.48 €
Të ardhura tjera nga transporti i mallrave	11,811.56 €
Total shitjet	478,406.04 €
Shpenzimet direkte në transportin e mallrave	475,576.80 €
Shpenzimet indirekte në transportin e mallrave	170,931.36 €
Total shpenzimet	646,499.15 €
Fitimi/humbja operative	-168,093.12€
Fitimi/humbja në %	-26%

Tabela 4.1.4

Siç mund të shihet nga tabela më lart, transporti i mallrave ka pasur një humbje prej -168,093.12€ ose shpenzimet kanë qenë për 26% më të larta se të hyrat nga ky transport.

Transporti i mallrave në kostot indirekte ka marrë pjesë 12.54% të shpenzimeve totale të ndërmarrjes, kjo vjen nga ndarja e shpenzimeve me transportin e udhëtarëve në bazë të përqindjes së marrjes pjesë me tren/kilometra në komunikacion.

### Mallrat e transportuara gjatë periudhës janar – dhjetor 2023

Gjatë vitit 2023, nga 100% të mallrave të transportuara, 98% të tyre ka qenë transport vendor i xehes së nikelit dhe 2% transporti i shinave për binarë.





**Figura 4.1.2**

### Revokimi i trenave

Gjatë vitit 2023 ka pasur disa revokime të trenave të planifikuar, të cilat pasqyrohen në tabelën në vijim bashkë me vlerën e kompensimit sipas kategorive të ndara në transportin ndërkombëtar (import-export) dhe transport vendor:

Janar - Dhjetor 2023	Trena të revokuar me 0%	Trena të revokuar me 10%	Trena të revokuar me 20%	Trena të revokuar me 100%	Vlera në euro e revokimeve
<b>Import-Export</b>	<b>262</b>	<b>52</b>	<b>56</b>	<b>0</b>	<b>3,133.78 €</b>
<b>Vendor</b>	<b>0</b>	<b>726</b>	<b>150</b>	<b>15</b>	<b>5,234.00 €</b>
<b>Total</b>	<b>262</b>	<b>778</b>	<b>206</b>	<b>15</b>	<b>8,367.78 €</b>

**Tabela 4.1.5**

Në tabelën më lart shihet se gjatë vitit 2023 në import dhe eksport janë revokuar në total 370 trena të planifikuar. Nga këto revokime, me kompensim 0% janë 262 trena, me 10% janë 52 trena, me 20% janë 56 dhe me revokim 100% janë 0 trena. Revokimet me 0% janë nga shkak i mbylljes së Linjës së 10-të Hekurudhore nga punimet që janë duke u zhvilluar në rehabilitimin e saj, për të cilat revokime nuk ngarkohemi me shpenzime nga Menaxheri i Infrastrukturës.

Po ashtu, në tabelën më lart, shihet se gjatë vitit 2023 në transportin vendor në total janë 891 trena të revokuar. Nga këto revokime, me kompensim të shumës prej 10% të qasjes në binarë janë 726 trena, me 20% janë 150 trena dhe me kompensim prej 100% janë 15 trena. Revokimi i këtyre trenave ka ndodhur për shkak se NewCo Ferronikeli nuk ka transportuar sipas planifikimit, transporti me këtë klient është zhvilluar vetëm nga muaji korrik e deri në muajin tetor 2023, në pjesën tjetër të këtij viti nuk ka pasur fare transport.

## IV.2. TRANSPORTI I UDHËTARËVE

Transporti hekurudhor i udhëtarëve edhe gjatë vitit 2023 ka qenë i kufizuar për shkak të punimeve në rehabilitimin e Linjës së 10-të Hekurudhore, përkatësisht në Linjën e Hanit të Elezit. Gjatë këtij viti, transporti i udhëtarëve është realizuar vetëm në Linjën Prishtinë – Pejë dhe anasjelltas me katër trena në ditë, dy në shkuarje dhe dy në ardhje.

Gjatë vitit 2023 numri i përgjithshëm i udhëtarëve të transportuar ka qenë 70,517, ndërsa shuma e të hyrave nga shitja e biletave ka qenë 61,356.49€.

Krahasuar me vitin 2022, numri i udhëtarëve në vitin 2023 është për 1,179 më i ulët, apo shprehur në përqindje është për 1.64% më pak, ndërsa krahasuar me planifikimin, numri i udhëtarëve të transportuar është për 9,483 më i ulët, apo shprehur në përqindje -11.85%. Ndërsa, realizimi financiar krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar është për 246.31€ më i lartë apo 0.4%, ndërsa krahasuar me planifikimin, të hyrat për këtë periudhë raportuese janë për 1,356.49€ më të larta, apo 2.26%.

Në pjesën në vijim të këtij raporti paraqesim në formë tabelore të dhënat për performancën operative dhe financiare në transportin e udhëtarëve për vitin 2023 si dhe të dhënat krahasuese me ato të vitit 2022 si dhe me planifikimin për vitin 2023.

### Performanca operative në transportin e udhëtarëve në vitin 2023:

Përshkrimi - Udhëtarë	Numri i udhëtarëve
Realizimi i numrit të udhëtarëve në 2022	71,696
Realizimi i numrit të udhëtarëve në 2023	70,517
Planifikimi i numrit të udhëtarëve në 2022	80,000
Dallimi: Realizim 2023 - 2022	-1,179
Dallimi: Realizim - planifikim 2023	-9,483
Dallimi: Realizim( 2023 – 2022 ) në %	-1.64
Dallimi: Realizim – planifikim 2023	-11.85

Tabela 4.2.1

Siç shihet nga të dhënat në tabelën më lart, numri i udhëtarëve të transportuar gjatë vitit 2023 ka qenë më i ulët për 1.64% në krahasim me vitin 2022, ndërsa krahasuar me planifikimin realizimi ka qenë për 11.85% më i ulët.

Sqarim: Në numrin e përgjithshëm të udhëtarëve të transportuar nuk janë të përfshirë udhëtarët që janë të liruar nga pagesat e udhëtimit, pasi që ende nuk është krijuar ndonjë mekanizëm për evidentimin e tyre.

### Performanca financiare në transportin e udhëtarëve në vitin 2023:

Përshkrimi - Shitje e Biletave	Të hyrat
Realizim shitje të hyra 2022	61,110.18
Realizim shitje të hyra 2023	61,356.49
Planifikimi 2023	60,000.00
Dallimi: Realizim 2023 - realizim 2022	246.31
Dallimi: Realizim - planifikim 2023	1,356.49
Dallimi: Realizim 2023 - realizim 2022 në %	0.4
Dallimi: Realizim - planifikim 2023 në %	2.26

Tabela 4.2.2

Siç shihet nga të dhënat në tabelën më lart, realizimi financiar nga transporti i udhëtarëve gjatë vitit 2023 ka qenë më i lartë për 0.4% në krahasim me vitin 2022, ndërsa krahasuar me planifikimin realizimi ka qenë për 2.26% më i lartë.




Figura 4.2.1

## Të hyrat dhe shpenzimet nga transporti i udhëtarëve:

<b>Përshkrimi - Të hyrat</b>	
<b>Të hyrat nga transporti i udhëtarëve – OSHP - MMPHI</b>	<b>967,902.63 €</b>
<b>Të hyrat nga transporti i udhëtarëve - ME</b>	<b>655,275.00 €</b>
<b>Shitjet nga transporti i udhëtarëve</b>	<b>61,356.49 €</b>
<b>Total të hyrat</b>	<b>1,684,534.12 €</b>
<b>Shpenzimet direkte në TU</b>	<b>887,521.17 €</b>
<b>Shpenzimet indirekte në TU</b>	<b>916,633.84 €</b>
<b>Total shpenzimet</b>	<b>1,804,155.01 €</b>
<b>Fitimi / humbja operative</b>	<b>-119,620.88 €</b>

Tabela 4.2.3




Figura 4.2.2

Siç shihet nga tabela më lart, biznesi i transportit të udhëtarëve ka operuar me një humbje operative prej 6.63% gjatë periudhës raportuese, duke llogaritur të hyrat nga: OSHP-MMPHI, ME si dhe të hyrat nga shitja e biletave të udhëtarëve dhe transporteve të kontraktuara.

Vërejtje: Shpenzimet indirekte janë përlllogaritur në bazë të përqindjes së operimit të trenave duke marrë për bazë tren-kilometrat, ku ka rezultuar se trenat e udhëtarëve kanë operuar rreth 87.56% nga totali i tren-kilometrave që kanë operuar të gjithë trenat.

### IV.3. MIRËMBAJTJA E MJETEVE LËVIZËSE - MML

Në kuadër të mirëmbajtjes së mjeteve lëvizëse hekurudhore përfshihen mirëmbajtja e trenave motorikë, mirëmbajtja e lokomotivave transportuese, mirëmbajtja e lokomotivave manovruese, mirëmbajtja e vagonëve për transportin e udhëtarëve, mirëmbajtja e vagonëve për transportin e mallrave dhe punë të tjera për riparimin e vagonëve të huaj.

Realizimi i punimeve të kryera në mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse gjatë vitit 2023 është pasqyruar përmes tabelave si në vijim të këtij raporti si dhe janë bërë edhe krahasimet me realizimin në periudhën e njëjtë të vitit paraprak:

#### IV.3.1 Mirëmbajtja e trenave motorikë

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e servisimeve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e trenave motorikë të realizuara në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022:

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	2023	2022	Ndryshimi
1.	Servisime	0	0	0
2.	Riparime	0	0	0
3.	Kontrollime K1	0	0	0
4.	Kontrollime K3	0	0	0
5.	Kontrollime K6	0	0	0
6.	Gdhendja e rrotave	0	0	0

Tabela 4.3.1

Siç shihet nga të dhënat në tabelën më lart, gjatë vitit 2023 nuk ka pasur servisime të trenave motorikë për shkak se gjatë këtij viti nuk kanë qenë në operim.

#### IV.3.2 Mirëmbajtja e lokomotivave transportuese

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e servisimeve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e lokomotivave transportuese të realizuara në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022:

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	2023	2022	Ndryshimi
1.	Servisime	299	215	+84
2.	Riparime	40	35	+5
3.	Kontrollime K1	18	16	+2
4.	Kontrollime K3	3	6	-3
5.	Kontrollime K6	6	8	-2
6.	Gdhendje te rrotave	3	4	-1

Tabela 4.3.2

### IV.3.3 Mirëmbajtja e lokomotivave manovruese

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e servisimeve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e lokomotivave transportuese të realizuara në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022:

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	2023	2022	Ndryshimi
1.	Servisime	1	0	+1
2.	Riparime	12	7	+5
3.	Kontrollime K1	8	4	+4
4.	Kontrollime K3	2	2	0
5.	Kontrollime K6	2	1	-1

**Tabela 4.3.3.1**

Intervenimet për secilin mjet tërheqës gjatë vitit 2023:

Mjeti tërheqës	2620 005	2640 007	2640 008	2710 009	2640 010	2620 016	2760 001	2760 002	5800 004
Servisime	105	37	33			124	1		
Riparime	13	15	7			5	12		
Kontrollime mujore	4	7	3			4	8		
Kontrollime tremujore	1	1	1				2		
Kontrollime gjashtëmujore	1	2	1			2	2		
Gdhendje të rrotave	1					2			

**Tabela 4.3.3.2**

S - Servisim,  
R - Riparim,  
K1 - Kontrollime njëmujor,  
K3 - Kontrollime tremujor,  
K6 - Kontrollime gjashtëmujor

#### IV.3.4 Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e udhëtarëve

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e testimeve të komponentëve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e vagonëve të udhëtarëve të realizuara në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022:

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	2023	2022	Ndryshimi
1.	Kontrollime K1	68	88	-20
2.	Riparim në punëtori	72	51	27
3.	Gdhendje të rrotave	19	21	-2

Tabela 4.3.4

#### IV.3.5 Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e mallrave

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e testimeve të komponentëve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e vagonëve të mallrave të realizuara në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022:

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	2023	2022	Ndryshimi
1.	Kontrollime K3	23	24	-1
2.	Riparim në punëtori	3	5	-2
3.	Gdhendje të rrotave	1	5	-4

Tabela 4.3.5

#### IV.3.6 Riparimi i vagonëve të huaj

Riparimi/mirëmbajtja e vagonëve të huaj	2023	2022
NewCo Ferronikeli	5,748.00 €	3,422.00 €

Tabela 4.3.6

## V. PASQYRA E PERFORMANCËS FINANCIARE DHE REZULTATET

1. Gjendja financiare Janar – Dhjetor 2023
2. Gjendja në para të gatshme - raporti sipas bankës (31.12.2023)
3. Transaksionet e realizuara (Janar – Dhjetor 2023)
4. Bilanci i Gjendjes (Janar – Dhjetor 2023)

### V. 1. Gjendja financiare

Për periudhën raportuese janar-dhjetor 2023, kemi paraqitur gjendjen e të hyrave dhe shpenzime sipas pozicioneve dhe kategorive ekonomike.

#### V.1.1. Të hyrat

Në vijim është bërë përshkrimi i të hyrave të realizuara për secilin segment duke e bërë krahasimin e tyre me vitin paraprak.

**Transporti i mallrave:** gjatë vitit 2023 nga transporti i mallrave, janë realizuar të hyrat në vlerë 466,594.48€. Totali i të hyrave të planifikuara për vitin 2023 është 1,450,000.00€ dhe nga kjo del se kemi realizuar 32.18% nga totali i planifikuar.

Të hyrat nga transporti i mallrave eksport/import janë realizuar sipas kategorive që pasojnë: të hyrat nga importi janë realizuar përmes vijës kufitare Hani i Elezit, të cilat janë në shumën prej 31,928.42€, ndërsa nga eksporti nuk janë realizuar të hyra në këtë periudhë.

Transporti i brendshëm kryesisht është realizuar për “NewCo Ferronikeli”, dhe atë në transportin e xehe nga Medveci. Në këtë periudhë, nga ky lloj i transportit është realizuar shuma prej 434,666.06€.

**Transporti i udhëtarëve:** gjatë vitit 2023 është realizuar në shumën prej 1,684,534.12€.

Të hyrat e faturuara nga Transporti i Kontraktuar janë 967,902.63€, të hyrat e planifikuara nga subvencionimi për mbulimin e pjesës së humbjeve nga trenat tjerë të udhëtarëve janë realizuar në shumën prej 655,275.00€. Ndërsa, të hyrat nga biletat janë realizuar në shumën prej 61,356.49€. Shprehur në përqindje, realizimi i të hyrave totale të planifikuara për vitin 2023 nga transporti i udhëtarëve, është arritur në shkallën prej 85.50% të shumës së planifikuar prej 1,970,275.00€.

**Të hyrat nga shërbimet tjera:** gjatë vitit 2023, kanë arritur shumën prej 6,063.56€. Kjo shumë, nëse krahasohet me shumën e buxhetuar për vitin 2023, e cila është 30,000.00€ arrin shkallën prej 20.21% të realizimit. Këto të hyra janë realizuar nga RIV dhe vendosjet e vagonëve në binarë si dhe nga kontrata me kompaninë GCF.



**Të hyra tjera:** të cilat janë realizuar gjatë vitit 2023, kanë arritur shumën prej 34,957.69€. Këto të hyra janë realizuar nga shitja e derivateve për HK-Infrakos Sh.A. në shumën prej 25,575.61€ dhe nga shitja e skrapit (mbeturinat) në shumën prej 3,536.86€. Buxheti i planifikuar për të hyrat nga kjo kategori ka qenë 42,300.00€, shprehur në përqindje është realizuar 82.64% e planifikimit.

Të hyrat e realizuara gjatë kësaj periudhe janë jo të kënaqshme, arsyeja e mosrealizimit të planifikuar është si pasojë e ndërprerjes së transportit nga punimet që janë duke u zhvilluar në rehabilitimin e Linjës së Dhjetë Hekurudhore nga HK-Infrakos Sh.A, e cila ka ndikuar negativisht në realizimin e të hyrave për Trainkos Sh.A.

Varësisht nga fushëveprimi i secilit sektor, janë paraqitur të hyrat e realizuara, për të cilat pritshmëria dhe planifikimi kanë qenë më të larta, duke u bazuar edhe në planet e veprimit, të cilat duhet të realizohen sipas Planit të Biznesit. Në vitet në vijim, presim që sipas Planit të Veprimit të kemi rezultate pozitive në këtë aspekt.

### **V.1.2. Shpenzimet**

**Shpenzimet** për periudhën janar–dhjetor 2023, janë të klasifikuara sipas kategorive në vijim:

**Totali i kostos së shërbimit** për vitin 2023 është 729,292.41€, ndërsa planifikimi ka qenë në shumën prej 1,405,596.56€. Shkalla e realizimit është 51.88%.

**Shpenzimet e stafit** janë kategori tjetër e rëndësishme e cila ka arritur shumën prej 1,529,164.07€, dhe atë në paga dhe kontribute 1,528,308.07€, sigurim shëndetësor, trajnime dhe shpenzime tjera në vlerë prej 856.00€. Në total, nëse krahasojmë shumën e buxhetuar prej 1,700,000.00€ për vitin 2023, kuota e realizimit është arritur në shkallën prej 89.95%.

**Totali i shpenzimeve operative** arrin shumën prej 114,711.16€, kjo shumë është vetëm 85.35% nga shuma prej 134,400.00€ e parashikuar vitin 2023.

**Totali i shpenzimeve administrative** ka arritur në kuotën prej 21.05%, konkretisht në shumën prej 38,265.60€. Planifikimi për vitin 2023, i kësaj kategorie është 181,800.00€.

Shpenzimet sipas grupimeve në kode të posaçme janë të precizuara në tabelën e mëposhtme – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar – dhjetor 2023.


### V.1.3. Të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën Janar – Dhjetor 2023

	EMËRTIMI	Realizimi Janar- Dhjetor 2023	Planifikimi Janar- Dhjetor 2023	Diferenca	B/C (%)	Realizimi Janar- Dhjetor 2022
	A	B	C	D	E	F
<b>A</b>	<b>Shitjet</b>					
1	Transporti i mallrave	466,594.48	1,450,000.00	(983,405.52)	32.18	116,819.90
2	TU – MMPHI	967,902.63	1,300,000.00	(332,097.37)	74.45	1,062,671.82
3	TU – Ministria e Ekonomisë	655,275.00	610,275.00	45,000.00	107.37	610,275.00
4	TU – Shitja e Biletave	61,356.49	60,000.00	1,356.49	102.26	63,123.25
5	Shërbimet tjera	6,063.56	30,000.00	(23,936.44)	20.21	11,048.22
6	Të ardhurat nga riparimi i vagonëve	5,748.00	22,300.00	(16,552.00)	25.78	17,716.15
7	Të hyrat tjera jo operative	25,672.83	20,000.00	5,672.83	128.36	103,305.75
<b>I</b>	<b>TOTAL – TË HYRAT</b>	<b>2,188,612.99</b>	<b>3,492,575.00</b>	<b>(1,303,962.01)</b>	<b>62.66</b>	<b>1,984,960.09</b>
<b>B</b>	<b>Kostoja e shërbimit/blerjes së materialeve</b>					
1	Derivatet dhe lubrifikantet	415,518.71	836,000.00	(420,481.29)	49.70	434,844.02
2	Energjia elektrike dhe shërbimet tjera komunale	29,433.26	25,500.00	3,933.26	115.42	22,704.12
3	Inventar dhe pajisje	279.32	5,000.00	(4,720.68)	5.59	2,314.57
4	Material harxhues	-	1,600.00	(1,600.00)	-	-
5	Pjesë rezervë/mirëmbajtje dhe materiale tjera	44,330.55	50,000.00	(5,669.45)	88.66	19,277.20
6	Qasja në binarë	209,967.51	420,000.00	(210,032.49)	49.99	195,446.18
7	Sigurimi i palëve të treta	-	2,496.56	(2,496.56)	-	3,734.00
8	Tërheqja e trenave dhe qiraja e vagonëve të huaj	1,841.25	41,000.00	(39,158.75)	4.49	2,621.94
9	Shpenzimet e transportit Infrakos	25,559.10	20,000.00	5,559.10	127.80	26,336.50
10	Servisimi i arkave fiskale	2,362.71	4,000.00	(1,637.29)	-	-
11	Zbritjet e lejuara	-	-	-	-	17,141.36
12	Mospërputhja e stokut	-	-	-	-	(2,977.76)
	<b>TOTAL – KOSTOJA E SHËRBIMIT</b>	<b>729,292.41</b>	<b>1,405,596.56</b>	<b>(676,304.15)</b>	<b>51.88</b>	<b>721,442.13</b>
	Fitimi (humbja) bruto	1,459,320.58	2,086,978.44	(627,657.86)	69.93	1,263,517.96
	<b>TË ARDHURAT TJERA</b>					
1	Të ardhurat e jashtëzakonshme	-	-	-	-	-
2	Të hyrat e shtyra (shpenzimet)	-	-	-	-	9,414.32
3	Të hyrat nga shitja e skrapit (shitja e aseteve)	-	-	-	-	-
4	Të ardhura tjera (shitja e skrapit-mbeturinat)	3,536.86	-	3,536.86	-	-
	<b>TOTAL – Të ardhurat tjera</b>	<b>3,536.86</b>	<b>-</b>	<b>3,536.86</b>	<b>-</b>	<b>9,414.32</b>
<b>C</b>	<b>Shpenzimet e stafit</b>					
1	Pagat dhe kontributet	1,528,308.07	1,695,000.00	(166,691.93)	90.17	1,674,194.22
2	Sigurimi shëndetësor, trajnimet dhe shpenzimet tjera	856.00	5,000.00	(4,144.00)	17.12	410.00

	<b>TOTAL - Shpenzimet e stafit</b>	<b>1,529,164.07</b>	<b>1,700,000.00</b>	<b>(170,835.93)</b>	<b>89.95</b>	<b>1,674,604.22</b>
<b>D</b>	<b>Shpenzimet operative</b>					
1	Mirëmbajtjet dhe riparimet	3,514.47	10,000.00	(6,485.53)	35.14	9,503.29
2	Shpenzimet logjistike	11,189.03	25,000.00	(13,810.97)	44.76	26,352.20
3	Energjia elektrike dhe komunalitë	4,496.60	7,000.00	(2,503.40)	64.24	5,079.89
4	Kontrollimet sistematike	1,350.00	2,500.00	(1,150.00)	54.00	1,900.00
5	Marketingu	2,588.66	16,600.00	(14,011.34)	15.59	6,363.54
6	Udhëtimet zyrtare	-	4,000.00	(4,000.00)	-	-
7	Telefonat dhe Posta	11,193.58	15,800.00	(4,606.42)	70.85	12,013.67
8	Shërbimet bankare	677.22	1,500.00	(822.78)	45.15	1,138.12
9	Tatimet	70,984.48	42,000.00	28,984.48	169.01	103,865.52
10	Pajisjet elektronike	2,627.71	10,000.00	(7,372.29)	26.28	2,025.46
11	Shpenzimet e interesit të kredisë	6,089.41	-	6,089.41	-	1,748.78
	<b>TOTAL - Shpenzimet operative</b>	<b>114,711.16</b>	<b>134,400.00</b>	<b>(19,688.84)</b>	<b>85.35</b>	<b>169,990.47</b>
<b>E</b>	<b>Shpenzimet administrative</b>					
1	Inventar dhe pajisje	1,557.15	10,000.00	(8,442.85)	15.57	416.18
2	Konsulenca dhe auditimi i jashtëm	1,224.56	43,500.00	(42,275.44)	2.82	7,110.26
3	Material i zyrës	8,375.88	16,000.00	(7,624.12)	52.35	14,819.54
4	Material sanitar	1,714.06	6,000.00	(4,285.94)	28.57	2,314.69
5	Qiraja për objektet	13,727.00	12,000.00	1,727.00	114.39	13,283.41
6	Reprezentacioni dhe bufeja	2,650.06	4,000.00	(1,349.94)	66.25	2,945.30
7	Shpenzimet gjyqësore dhe ndëshkimet	702.45	35,000.00	(34,297.55)	2.01	6,684.65
8	Shpenzimet logjistike	7,844.95	25,300.00	(17,455.05)	31.01	8,213.62
9	Kontingjentet	469.49	30,000.00	(29,530.51)	1.56	2,070.00
	<b>TOTAL - shpenzimet administrative</b>	<b>38,265.60</b>	<b>181,800.00</b>	<b>(143,534.40)</b>	<b>21.05</b>	<b>57,857.65</b>
	<b>Provizionimi i llogarive të arkëtueshme</b>	<b>3,553.20</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>164,126.97</b>
<b>II</b>	<b>TOTAL -SHPENZIMET (B+C+D+E)</b>	<b>2,414,986.44</b>	<b>3,421,796.56</b>	<b>(1,006,810.12)</b>	<b>70.58</b>	<b>2,788,021.44</b>
<b>III</b>	<b>Fitimi (Humbja) para zhvlerësimit</b>	<b>(222,836.59)</b>	<b>70,778.44</b>	<b>(293,615.03)</b>	<b>(314.84)</b>	<b>(793,647.03)</b>
	<b>GRANTET</b>	<b>368,524.68</b>	<b>440,000.00</b>	<b>(71,475.32)</b>	<b>83.76</b>	<b>490,459.25</b>
<b>F</b>	<b>Shpenzimet e zhvlerësimit</b>		<b>-</b>			
1	Shpenzimet e zhvlerësimit që janë rezultat i granteve	368,524.68	440,000.00	(71,475.32)	83.76	490,459.25
2	Shpenzimet e zhvlerësimit që janë nga buxheti i ndërmarrjes	50,128.03	60,000.00	(9,871.97)	83.55	54,955.81
	<b>TOTAL - shpenzimet e zhvlerësimit</b>	<b>418,652.71</b>	<b>500,000.00</b>	<b>(81,347.29)</b>	<b>83.73</b>	<b>545,415.06</b>
<b>G</b>	<b>Fitimi (humbja) nga veprimtaria</b>	<b>(272,964.62)</b>	<b>10,778.44</b>	<b>(283,743.06)</b>	<b>(2,532.51)</b>	<b>(848,602.84)</b>


Tabela 5.1

## Pjesëmarrja e të hyrave sipas llojit të shërbimit për vitin 2023



Diagrami 5.1

## Pjesëmarrja e shpenzimeve sipas kategorive për vitin 2023



Diagrami 5.2

## V. 2. Gjendja në para të gatshme – raporti sipas bankës (31.12.2023)

Nr.	EMËRTIMI	Saldo 31-12-2023
1.	PCB nr. 1114-004229-0001-59	358,104.90
2.	PCB (KTh) nr. 1114-004229-0101-50	0.00
3.	BKK - PCB (K) nr. 1114-004229-0201-41	0.37
4.	BKK - PCB (S) nr. 1114-004229-0301-32	49,432.00
5.	BKK - PCB (M) nr. 1114-004229-0401-23	114,123.39
6.	GH-PCB nr. 1114004229040114	87.52
	<b>TOTALI</b>	<b>521,748.18</b>

Tabela 5.2

### V.3. Transaksionet e realizuara (Janar – Dhjetor 2023)

Në tabelat në vijim janë paraqitur transaksionet e ndërmarrjes në llogaritë rrjedhëse dhe ato në projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës dhe llogaritë rrjedhëse për subvencione:

Transaksionet në llogaritë rrjedhëse	
Gjendja në llogaritë e ndërmarrjes më 01.01.2023	297,866.53
Inkasimet e pranura gjatë muajve janar – dhjetor 2023	616,862.38
Pagesat e kryera gjatë muajve janar – dhjetor 2023	556,624.01
Gjendja në llogaritë e ndërmarrjes më 31.12.2023	358,104.90

Tabela 5.3

Transaksionet në projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës	
Gjendja në llogaritë e ndërmarrjes më 01.01.2023	531.87
Inkasimet e pranura gjatë muajve janar – dhjetor 2023	28,933.56
Pagesat e kryera gjatë muajve janar – dhjetor 2023	29,465.06
Gjendja në llogaritë e ndërmarrjes më 31.12.2023	0.37

Tabela 5.4

Transaksionet e ndërmarrjes nga subvencionet (MI dhe ME)	
Gjendja në llogaritë e ndërmarrjes më 01.01.2023	412,244.31
Inkasimet e pranura gjatë muajve janar – dhjetor 2023	1,819,572.47
Pagesat e kryera gjatë muajve janar – dhjetor 2023	2,068,261.39
Gjendja në llogaritë e ndërmarrjes më 31.12.2023	163,555.39

Tabela 5.5

Në tabelën më poshtë janë paraqitur transaksionet më të mëdha gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2023 për deponimet dhe pagesat:

Deponimet Janar-Dhjetor 2023			Pagesat Janar-Dhjetor 2023		
1	Deponime nga MMPHI	1,058,297.47	1	Pagat e punëtorëve	1,298,486.56
2	Deponime nga Ministria e Ekonomisë	655,275.00	2	Pagesa e derivateve	545,827.98
3	Deponime nga NewCo Ferronikeli	315,836.85	3	Pagesë për ATK	184,919.52
4	Deponime nga BK për Investime Kapitale	28,933.56	4	Pagesë për Infrakos Sh.A	114,549.84
5	Deponime nga transporti i udhëtarëve	56,631.00	5	Pagesë për Investime kapitale	73,226.04
6	Deponimet tjera	47,924.60	6	Pagesa tjera	134,870.58
<b>TOTALI</b>		<b>2,162,898.48</b>	<b>TOTALI</b>		<b>2,351,880.52</b>

Tabela 5.6

#### V.4. Bilanci i gjendjes (Janar – Dhjetor 2023)

<b>BILANCI I GJENDJES</b>		
<b>NP TRAINKOS SH.A</b>	<b>GJENDJA FILLESTARE 01.01.2023</b>	<b>GJENDJA PERFUNDIMTARE 31.12.2023</b>
<b>Mjetet themelore - vlera neto sipas librave</b>	<b>2,440,607.65</b>	<b>2,088,085.07</b>
<b>Mjetet Qarkulluese</b>	<b>1,774,234.71</b>	<b>1,402,147.39</b>
Stoqet	426,548.91	412,828.61
Paraja	711,382.59	522,806.17
Llogarite e arkëtueshme	596,177.04	443,537.80
Kërkesa tjera të arkëtueshme	30,386.55	6,549.72
Parapagimet	9,739.62	16,425.09
<b>Total Mjetet Qarkulluese dhe Themelore</b>	<b>4,214,842.36</b>	<b>3,490,232.46</b>
<b>Detyrimet afatshkurta</b>	<b>2,049,681.17</b>	<b>1,961,180.08</b>
Llogaritë e pagueshme	886,770.10	640,200.53
Të pagueshme tjera - detyrime	1,351.49	874.84
Detyrime tatimore	796,596.58	955,141.71
Detyrimet e kredisë	364,963.00	364,963.00
<b>Detyrimet afatgjata</b>	<b>1,865,352.80</b>	<b>1,459,423.18</b>
<b>Kapitali</b>	<b>5,289,481.93</b>	<b>5,292,179.92</b>
Fitimi/Humbja e bartur	(4,141,429.31)	(4,949,586.10)
Fitim/Humbja e vitit	(848,244.23)	(272,964.62)
<b>Total detyrimet dhe kapitali</b>	<b>4,214,842.36</b>	<b>3,490,232.46</b>

Tabela 5.7

## VI. PROJEKTET KAPITALE

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të gjitha projektet/kontratat për vitin 2023, të financuara nga Buxheti Operativ i Trainkos Sh.A. dhe Buxheti i Kosovës.

Nr.	Titulli i Aktivitetit të Prokurimit	Data e nënshkrimit	Vlera e parashikuar	Vlera e kontratës	Koment
1	Shërbimet e shtypjes së orarit të lëvizjes së trenave	Tetor	500.00	270.00	Përfunduar
2	Servisimi dhe mbushja e aparateve kundër zjarrit	Tetor	600.00	586.46	Përfunduar
3	Furnizimi dhe montimi i perdeve në objektin e Trainkos Sh.A	Nëntor	3,400.00	1,946.07	Përfunduar
4	Furnizimi me modul TH14 për lokomotivën GM 645	Nëntor	8,000.00	6,714.20	Përfunduar
5	Furnizimi me mbushës për bateri të lokomotivave	Nëntor	8,500.00	8,011.02	Përfunduar
6	Furnizimi me materiale promovuese	Nëntor	1,100.00	528.05	Përfunduar
7	Furnizim me material administrativ	Dhjetor	2,615.00	2,746.80	Në implementim
8	Shërbimet e auditimit të pasqyrave financiare për vitin 2023, 2024, 2025	Dhjetor	9,500.00	7,839.97	Në implementim
9	Furnizimi me tonerë për nevoja të Trainkos Sh.A	Dhjetor	1,473.00	1,386.97	Në implementim
10	Furnizimi me papuçe frenuese për lokomotiva	Dhjetor	12,761.70	12,761.70	Përfunduar
11	Mirëmbajtja e sistemit financiar PLANET ACCOUNTING	N/A	11,800.00	11,800.00	Në implementim
12	Riparimi i pajisjeve dhe mjeteve lëvizëse hekurudhore - Ndërrimi i rrotave në karretat rrotulluese të lokomotivës JT38CW	Shtator	130,000.00	129,497.72	Në implementim
13	Furnizimi me goma për automjetin Dacia	Shtator	250.00	237.20	Përfunduar
14	Furnizimi dhe instalimi i	Shkurt	2,850.00	2,633.17	Përfunduar

	ulluqeve në objektin e Administratës				
15	Rregullimi i gjeneratorit	Shkurt	210.00	205.00	Përfunduar
16	Furnizimi me goma për automjete të Trainkos	Shkurt	600.00	592.00	Përfunduar
17	Furnizimi me reflektorë për objektet e ndërmarrjes	Gusht	450.00	349.99	Përfunduar
18	Shërbimet e matjes së kënaqshmërisë së klientëve	Shtator	975.00	496.00	Në implementim
19	Furnizimi me ujë të pijshëm	Shtator	2,620.00	2,370.95	Në implementim
20	Furnizimi me switch	Gusht	1,960.00	1,151.34	Përfunduar

**Tabela 5.8**



## VII. AKTIVITETET NË PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E BIZNESIT

### VII.1. Planifikimi dhe zhvillimi i biznesit

Viti 2023 ka vazhduar me plotësimin e detyrave dhe obligimeve sipas Planit të Punës të përgatitur në fillim të vitit të ndara në periudha tremujore. Një ndërprerje në realizimin e planifikimeve dhe aktiviteteve është bërë për shkak të pamundësisë së realizimit të “Strategjisë Afatmesme të Investimeve për Trainkos-in 2020 - 2024”, të aprovuar në muajin nëntor të vitit 2019 nga Bordi i Drejtorëve. Me këtë Strategji parashihen të definoohen politikat zhvillimore të Trainkos-it, të koordinuara me Qeverinë dhe akterët tjerë të sektorit hekurudhor brenda dhe jashtë vendit. Njëkohësisht, do të koordinohet edhe qasja tek IFN-të në koordinim me ministrinë përkatëse brenda Qeverisë së Kosovës për investime adekuate sipas zhvillimeve tjera në sektor, konkretisht reformave në legjislacion dhe modernizim të linjave hekurudhore. Por, pritjet kanë qenë të njëjta, si në vitet paraprake, ashtu edhe në vitin 2023 zbatimi i reformave të shumëpritura në sektorin hekurudhor nuk ka ndodhur.

Viti 2023 konsiderohet si periudhë e përpjekjeve dhe tentimeve për realizimin e detyrave sipas planifikimeve dhe dokumenteve strategjike të ndërmarrjes. Koordinimi i dokumenteve strategjike shkon paralel me dokumentin e aprovuar nga Qeveria – “Strategjia e Transportit Multimodal 2023 – 2030” dhe dokumenti i cili është në fazën përfundimtare që është krijuar sipas këtij dokumenti “Plani i Veprimit për zbatimin e Strategjisë së Transportit Multimodal 2023 – 2025”.

Gjendja e krijuar në Trainkos Sh.A. dhe nga trendi i zhvillimeve është e rënduar, parashikimet dhe përlllogaritjet vjetore nuk janë realizuar, edhe më keq projeksionet e parapara për vitin 2023 kanë krijuar bazë për fillimin e vitit 2024.

Mund të potencohen problemet e Trainkos Sh.A. për zhvillimin e aktivitetit në ofrimin e shërbimeve gjatë vitit për të cilin po raportohet.

Konkretisht, në ngecjen apo kthimin prapa të zhvillimeve të transportit hekurudhor kanë ndikuar:

- Stërzgjatja në zbatimin e projektit për Modernizimin e Linjës së 10-të Hekurudhore, sesioni Fushë Kosovë – Hani i Elezit dhe fillimi i zbatimit të sesionit Fushë Kosovë – Mitrovicë;
- Ndërprerja e përkohshme e transportit nga kompania NewCo Ferronikeli;
- Amandamentimi/ndryshimi i Ligjit për Hekurudhat, përpilimi dhe futja në funksion e Ligjit për Siguri dhe Interoperabilitet, legjislacioni primar dhe sekondar (zbatimin e Direktivave Evropiane për transport), rregulloret adekuate të fushave të ndryshme për sektor (siguria, interoperabiliteti dhe transporti i mallrave të rrezikshme) dhe rregulloret e udhëzimet të secilit entitet hekurudhor veç e veç, etj.) dhe

- Reformimi i funksionimit të Trainkos-it si operator strategjik në pronësi të Qeverisë së Republikës së Kosovës në harmoni me reformat e aprovuara shtetërore dhe praktikave të mira ekzekutive.

### **Pjesëmarrja e Trainkos-it në iniciativat e BE-së për reforma në transportin hekurudhor përmes Lëvizshmërisë së Qëndrueshme**

Politikat e BE-së imponojnë reformat në transportin hekurudhor sipas konceptit të “Lëvizshmërisë së Qëndrueshme”. Për reformat e tilla, përmes dhe për Sekretariatit për zbatimin e Traktatit për Transport janë shkëmbyer iniciativa dhe raporte përmbyllëse vjetore.

Politikat e BE-së, siç tashmë është e ditur, imponojnë reformat në transportin hekurudhor sipas konceptit të “Lëvizshmërisë së Qëndrueshme”. Për reformat e tilla, përmes dhe për Sekretariatit për zbatimin e Traktatit për Transport janë shkëmbyer iniciativa dhe raporte përmbyllëse vjetore.

Gjatë periudhës raportuese, janë realizuar këto aktivitete:

1. Më 21 Shkurt 2023 nën patronatin e Ministrit të MMPHI-së, z. Liburn Aliu, në Prishtinë, është mbajtur Samiti për Hekurudha të Shkëlqyeshme, për krijimin e një institucioni shkollor për trajnimin dhe edukimin e stafit hekurudhor sipas praktikave dhe obligimeve bashkëkohore në transportin me hekurudhë;
2. Më datën 22 Shkurt 2023 është mbajtur takimi i radhës së Komitetit Teknik, i cili fuqizon angazhimin e kompanive hekurudhore në avancimin e proceseve zhvillimore; (Me Vendimin e MMPHI-së është bërë emërimi i përfaqësuesve të rinj të Kosovës në Komitetin Teknik për Hekurudha (Sekretariati për Zbatimin e Traktatit për Transport), nga Infrakos-i dhe Trainkos-i.)
3. Më 23.02.2023 nën organizimin e ERA-s (Agjencia Evropiane për Hekurudha) është mbajtur trajnimi/këshillimi për zhvillimet në legjislacionin për trajnimin dhe licencimin e makinistëve;
4. Takimi i radhës të Komitetit Teknik për Hekurudha i mbajtur në Doboj (Bosnje dhe Hercegovinë), përfaqësim online;
5. Më 05-06.10.2023 është mbajtur takimi i radhës me përfaqësim online (Zagreb), dhe
6. Më 05-06 dhjetor është mbajtur takimi i fundit i Komitetit Teknik për vitin 2023 (Athinë). Vlen të përmendet se në këtë takim është:
  - Miratuar Plani i Punës 2023 që reflekton në Raportin e Progresit për Kosovën në vitin 2023;
  - Është punuar drafti i Planit të Punës për vitin 2024 dhe
  - Bashkë kryesues i KT do të jetë përfaqësuesi i Kosovës sipas radhës.
7. Më 12-13 dhjetor 2023, në Shkup, Trainkos-i ka qenë me pjesëmarrës në punëtorinë “Shpërndarja e SIT në shtetet e Ballkanit Perëndimor”.

## **Tregu i transportit hekurudhor dhe problemet e Trainkos-it në realizimin e kërkesave për transportin e mallrave dhe udhëtarëve**

Problemet e mjeteve lëvizëse mbesin të hapura si për TU ashtu edhe për TM, edhe përkundër përsëritjes së vazhdueshme të kërkesës për pasurimin e flotës së mjeteve lëvizëse ende nuk kemi ndonjë përgjigje se a do të procedohet kërkesa jonë për t'i mundësuar Trainkos-it t'i ketë në flotën e sajë mjetet lëvizëse të përshtatshme për plotësimin e kërkesave për transportin e mallrave dhe udhëtarëve. Pasi që flota e lokomotivave paraqet problem në vete, si për vëllimin minimal të transportit aktual, po ashtu edhe në fillimin e një fluksi të madh të mundshëm transporti të mallrave dhe udhëtarëve sipas paralajmërimeve. Po ashtu, sigurimi i stafit të ri teknik dhe të trajnuar paraqet një sfidë në vete për ndërmarrjen, që duhet të konsiderohet për veprim gjithashtu.

Rifillimi i transportit ndërkombëtar për NewCo Ferronikeli nuk ka qenë i mundur për shkak të mbylljes së Linjës së 10-të Hekurudhore nga punimet në rehabilitimin e saj.

Transporti i thëngjillit nga KEK-u dhe koncentratit/mbetjeve xeherore nga “Trepça” si potencial i mundshëm, duke përfshirë edhe kthimin e transportit të kontejnerëve dhe derivateve të naftës, kërkon mobilizim të plotë dhe veprime të përgjegjshme nga kompetentët qeveritarë dhe të ndërmarrjes. Në hapësirat e ME-së janë mbajtur dy takime për krijimin e mundësive të transportit të thëngjillit nga KEK-u për Maqedoninë Veriore, mirëpo problemi qëndron në riaftësimin e linjës/binarit industrial brenda KEK-ut, gjë që pamundëson çfarëdo planifikimi të mundshëm brenda vitit 2024.

Rritja e zhvillimit të kapaciteteve në transportin e mallrave dhe udhëtarëve po ashtu kërkon përkushtim paralel edhe në mirëmbajtjen e tyre. Kjo ka ndikim direkt në plotësimin e kriterëve standarde për shëndet dhe siguri, të përcaktuara nga direktivat në fuqi që përcillen në zbatim nga asociacionet hekurudhore të Evropës dhe të kërkuara për zbatim prej ERA-s (Agjencinë Evropiane për Hekurudha). Reformat dhe zhvillimet në transportin hekurudhor, modernizimi i linjave hekurudhore dhe krijimi i mundësive për blerjen e mjeteve lëvizëse të reja kërkon që Trainkos-i për vitet në vijim të plotësojë kriteret për mirëmbajtje të të njëjtave (me licencë adekuate), konkretisht me punëtorë dhe staf adekuat për këto detyrime.

## **VII.2. Koordinimi i proceseve me MMPHI, ARH-në dhe Institucionet tjera relevante**

Periudha raportuese Janar – Dhjetor 2023 gjithashtu rezultoi me angazhimin e vazhdueshëm në plotësimin e obligimeve në raport me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), Sekretariatit, ARH-në, Ministrinë e Ekonomisë (ME), ESK (Enti Statistikor i Kosovës) dhe KHAIA:

- Me Komisionin e MMPHI-së është punuar intensivisht për fillimin e zbatimit të Marrëveshjes së OShP-së 2023 – 2027 dhe përfundimin procesit në baza mujore;
- U janë përcjell statistikatat e nevojshme për nevojat e Sekretariatit të Zbatimit të Traktatit për Transport;
- Departamenti i Rregullimit të Tregut në kuadër të ARH-së, duke u bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë që ka, është furnizuar me statistika zyrtare për transportin e mallrave dhe udhëtarëve në periudha të rregullta mujore;
- Me Departamentin e Sigurisë (ARH) është proceduar me kërkesën për tërheqjen e Autorizimit të mjeteve lëvizëse të cilat janë shitur si skrap, konkretisht edhe me çregjistrimin e të njëjtave nga lista e NVR-së;
- Enti Statistikor i Kosovës është furnizuar me statistika zyrtare për transportin e mallrave dhe udhëtarëve në periudha të rregullta raportuese sipas kërkesës;
- Pjesëmarrje aktive me përfaqësim zyrtar nga Trainkos-i në përgatitjen e konceptit dokumentit për ndryshimin/amandamentimin e Ligjit për Hekurudhat e Kosovës (Nr. 04/L -063);
- Pjesëmarrje aktive në përfundimin e Strategjisë së SIT (Sistemi Inteligent për Transport) dhe
- Është bërë kërkesa për licencë për katër makinistë.

**Problemet e hasura gjatë zhvillimit të aktivitetit të HK-Trainkos Sh.A. në vitin 2023, të reja dhe të bartura nga vitet e kaluara vazhdojnë të mbesin të njëjta dhe mund të grupohen në:**

Stërzgjatja në zbatimin e projektit për Modernizimin e Linjës së 10-të Hekurudhore, sesioni Fushë Kosovë – Hani i Elezit dhe fillimi i zbatimit të sesionit Fushë Kosovë – Mitrovicë.

Realizimi i projektit “Modernizimi i Linjës së 10-të Hekurudhore” është përcjell me ndërprerje të pjesshme e të plota të transportit hekurudhor, sidomos në Linjën Fushë Kosovë – Hani i Elezit, gjë që për HK-Trainkos Sh.A. ka krijuar pasoja.

Që nga fillimi i zbatimit të projektit (Korrik 2019) kanë filluar ndërprerjet e qarkullimit sipas periudhave të kohëpaskohshme me orar të paralajmëruar (OLT-së – Orari i Lëvizjes së Trenave për vitin përkatës) dhe i njëjti nuk është arritur që të zbatohet në përpikëri dhe në afatet e miratuara në Kontratë. Me kalimin e kohës, nga vonesat në zbatimin e projektit, Trainkos-i ka humbur klientët e vet dhe kredibilitetin e tij përballë tyre. Përkundër tentimeve, për të realizuar ndonjë transport sipas kërkesave të klientëve tanë, nuk ka pasur mundësi nga mos përcaktimi i saktë i datave për rihapje të përkohshme dhe kohës së pamjaftueshme për të realizuar ndonjë transport sipas kushteve tjera që imponohen nga sesionet tjera nga pika fillestare deri tek destinacioni final.

Projekti, sipas dinamikës, do të duhej të përfundonte në dhjetor të vitit 2021, gjë që as deri më sot nuk ka ndodhë dhe gjendja veç sa është përkeqësuar. Që nga muaji korrik 2022 linja ishte e mbyllur në tërësi, po ashtu edhe gjatë gjithë vitit 2023 linja ishte e mbyllur, por hapej në periudha të shkurta dhe me shpejtësi të kufizuar. Vazhdimi i punëve në realizimin e projektit sipas paralajmërimeve mundëson hapjen e linjës nga 10 ditë pas mbylljeve prej 50 ditëve.

Mbyllja e kësaj linje ka bërë që transporti ynë ndërkombëtar për nevojat e kërkuesve të shërbimit dhe posaçërisht të klientit tonë kryesor – NewCo Ferronikeli të ndërpritet, pas një periudhe prej mbi 15 vite të bashkëpunimit (nga shtatori 2007). Planifikimet kryesore për të hyrat e ndërmarrjes për vitin 2023 nga transporti ndërkombëtar i mallrave kanë qenë të bazuara mbi zotimet e këtij klienti për transportin e xehes që vjen me tri anije brenda vitit deri në Portin e Selanikut e që është parakusht për shfrytëzim/eksplorim të xehes vendore.

Pas më shumë se 15 vite të zhvillimit të transportit hekurudhor ndërkombëtar, transporti i xehes për NewCo Ferroikeli-n është zhvendosur nga Porti i Selanikut përmes hekurudhës, tek Porti i Durrësit me transport alternativ.

Situata e përshkruar, zbatimi i “Strategjisë së Transporti Multimodal 2023 – 2030 (STMM)” dhe obligimet që dalin për të zhvilluar transportin hekurudhor brenda dhe jashtë vendit argumenton nevojën e angazhimit të gjithë spektrit ekzekutiv dhe qeveritarë për të krijuar parakusht në zhvillimin e operatorit hekurudhor (Trainkos-it). Konkretisht reformat e kërkuara (sipas standardeve të BE-së) duhet të reflektojnë edhe në reformat e domosdoshme të parapara në Planin Zhvillimor Kombëtar (PZhK) 2023 – 2030 dhe STMM për të njëjtën periudhë. Nga kjo, Ministrinë përkatëse të Qeverisë duhet ta përfshijnë Trainkos-in në planet investive për periudhat e ardhshme që duhet të rezultojnë me zbatimin e planifikimeve në reforma.

### **Pasurimi i flotës së mjeteve lëvizëse, ndikimi në plotësimin e parakushteve për zbatimin e Marrëveshjes së OShP-së**

Trainkos-i ka të trashëguar mjete lëvizëse, që plotësojnë kërkesat minimale për Transportin e Mallrave (TM) dhe Transportin e Udhëtarëve (TU). Përkundër përsëritjes së vazhdueshme të kërkesës për nevojën e pasurimit të flotës së mjeteve lëvizëse nuk kemi ndonjë lëvizje për t'i mundësuar Trainkos-it që të ketë në flotën e saj mjetet lëvizëse të përshtatshme për plotësimin e kërkesave për transport të mallrave dhe udhëtarëve. Buxheti vjetor tanimë i njëjtë me vite nuk mjafton as për riparimin e mjeteve lëvizëse ekzistuese e lëre më për të filluar me domosdoshmërinë e furnizimit me mjete lëvizëse të reja. Kjo domosdoshmëri është precizuar në STMM 2023 -2030” e që del nga PZhK 2023-2030 dhe reformat tjera të sektorit në proces, konkretisht do të zbatohet dhe fuqizohet kufizimi për mjetet lëvizëse që nuk janë në përputhje me kërkesat (specifike ERTMS) në mënyrë që të motivohen operatorët për të rinovuar mjetet e tyre lëvizëse. Problemet e mjeteve lëvizëse ekzistuese mbesin të hapura si për TU ashtu edhe për TM, furnizimi me mjete lëvizëse adekuate të reja imponohet më tepër se renovimi, modernizimi

apo blerja e mjeteve lëvizëse të përdorura që janë jashtë mundësive për të plotësuar kërkesat e operimit me standarde të reja në binarë të rinovuar.

Strategjia e Transportit Multimodal (STM) 2023 – 2030 e miratuar nga Qeveria në Janar 2023 e që është në ndërlidhje me Planin Kombëtar për Zhvillim në objektivat kryesore përfshin:

1. Lidhja e transportit pa probleme;
2. Krijimin e një sistemi të sigurt të transportit – drejt vizionit zero të emetimit dhe
3. Krijimin e transportit të mençur dhe digjital.

Përveç çështjeve tjera të precizuara në STMM e që dokumentojnë nevojën për avancimin e proceseve për transportin me hekurudhë mund të shkëpusim edhe tekstin (shih dokumentin, faqe 28): *“Për të shfrytëzuar sistemin ndërveprues hekurudhor është gjithashtu i nevojshëm edhe modernizimi i mjeteve lëvizëse. Që të ndodh kjo, do të zbatohet dhe fuqizohet kufizimi për mjetet lëvizëse që nuk janë në përputhje me kërkesat në mënyrë që të motivohen operatorët për të rinovuar mjetet e tyre lëvizëse”.*

Me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës është nënshkruar dhe ka filluar së zbatuari Marrëveshja e re pesë vjeçare (2023 – 2027) më 18.01.2023 për Obligimet e Shërbimeve të Publikut (OSHP).

Planifikimet kryesore për të hyrat e ndërmarrjes për vitin 2023 nga transporti i udhëtarëve kanë qenë të bazuara në Marrëveshjen e OSHP-së 2023 – 2027, konkretisht për vitin 2023 në kodet përkatëse buxhetore:

1. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës – 1,300,000.00€ dhe
2. Ministria e Ekonomisë – 610,275.00€.

Me faturimin final (Dhjetorin 2023 sipas mesatares 1/11-a) për vitin 2023 kemi faturuar sipas shpenzimit real MMPHI-së shumë prej 1,058,297.47€, nga kjo del se në mungesë të trenave për Hanin e Elezit kemi mbetje prej 241,702.53€ prej shumës 1,300,000.00€ të buxhetit nga MMPHI-ja. Andaj me buxhetin e aprovuar për shpenzime kapitale në ME, shuma 489,725.00€ për vitin 2023 por edhe për vitin 2024 gjithashtu, natyrisht se nuk mjafton dhe sigurimi i mjeteve financiare dhe shfrytëzimi i mundësive për të siguruar mjete lëvizëse është problemi kyç që kërkon vëmendje. Mungesa e transportit krijon problemin tjetër që pamundëson “mbijetesën” e Ndërmarrjes.

Në periudhën raportuese dhe vazhdimin e angazhimeve SPZhKSh dhe entitetet tjera përgjegjëse në ndërmarrje kanë shqyrtuar mundësitë për mbështetje nga potenciali i krijuara në relacione bilaterale me:

1. Hekurudhat Zvicerane – Pajisje për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse (në proces);
2. American Explorin and Mining LLC -(nuk kemi ndonjë konfirmim për realizimin e projektit ku Trainkos-i ka qenë pjesë përbërëse);
3. RubiRailtec – Southeast Europe - (Marrëveshja e bashkëpunimit nuk është nënshkruar ende, është në proces);

4. Banka Botërore - (presim të përfshihet problematika dhe mundësitë për progres në raportet që krijon ky institucion);
5. Konsullata e Kosovës në Gjermani (Angazhimi në kërkesa të mëtutjeshme varet nga shkalla e involvimit të faktorit politik, kryesisht të ME-së);
6. Metro Istanbul A.S. - (vullneti për bashkëpunim të ndërsjellë me procese të planifikuara është ndërprerë me rastin e katastrofës – tërmetit në Turqi dhe presim të rifillojmë diskutimet për rifillim të proceseve) dhe
7. Oda Ekonomike e Britanisë së Madhe në Kosovë – (duhet të kërkohet involvimi i pronarit – ME-së në shfrytëzimin e mundësive që ofrohen nga Hekurudhat e Britanisë së Madhe).

Projekti i transportit të pajisjeve të dhëna donacion nga Hekurudhat Zvicerane ka përfunduar me sukses, mirëpo vendosja e tyre në funksion kërkon investime për krijimin e kushteve për të vazhduar me shfrytëzimin e mundësive që ofrojnë.

SPZhKSh ka përcjellë dhe është direkt i involvuar në proceset për politikat shtetërore që kanë të bëjnë me sektorin hekurudhor, konkretisht me Trainkos-in dhe transportin e mallrave, transportin e udhëtarëve me hekurudhë dhe mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse. Ngjarjet/informatat më të rëndësishme janë:

1. Aprovimi i dokumentit “Strategjia e Transportit Multimodal 2023 – 2030;
2. Plani i Veprimtimit 2023 – 2025 për zbatimin e Strategjisë së Transportit Multimodal;
3. Fondi Sovran i Republikës së Kosovës;
4. Koncepti dokumenti për Ligjin e ri të Hekurudhave dhe Ligjin për Siguri dhe Ndërveprueshmëri (i përfunduar, pritet miratimi nga ZKM dhe fillimi i përpilimit të këtyre dy ligjeve);
5. Iniciativat, aprovimi dhe fillimi i studimeve të fizibilitetit për Linjën Durrës - Prishtinë dhe Porti i Thatë në Prishtinë dhe
6. Aprovimi i përfshirjes së Linjës Prishtinë – Fushë Kosovë – Aeroport në TEN-T.

### VII.3. Aktivitet e marketingut

Sa i përket fushës së Marketingut gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2023, angazhimi dhe aktivitetet kanë qenë në realizimin e objektivave të parapara në Planin e Biznesit për vitin 2023. Janë realizuar kryesisht aktivitetet të cilat kanë të bëjnë me përpilimin e kontratave të transportit, përpunimin e analizës së buxhetit të të hyrave për klientët e rregullt. Janë mbajtur kontakte me klientë dhe me partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë, janë pranuar kërkesa për shfrytëzimin e aseteve të Trainkos Sh.A, kryesisht për qëllime të xhirimeve, të cilat edhe janë miratuar. Po ashtu, janë bërë edhe përgatitjet e ofertave konkrete të udhëtimit me tren për Transport të Udhëtarëve.

Ndërsa, sa i përket pjesëmarrjes në fushën promovuese, nuk kemi qenë prezent në shumë kanale të marketingut për shkak të kostove të larta dhe për shkak të gjendjes financiare jo të mirë të ndërmarrjes. Përparësi në këtë drejtim, në fushën e promovimit të shërbimeve, gjatë vitit 2023, janë bërë përmes aplikacionit “Orari i Trenave”, që është krijuar nga persona me nevoja të veçanta për Trainkos Sh.A. Përmes këtij aplikacioni, personat që kanë të humbur shikimin, u mundësohet përmes zërit dëgjimi i orarit të lëvizjes së trenit dhe arritja e trenit në çdo stacion në relacionet: Prishtinë – Pejë – Prishtinë dhe Prishtinë – Shkup – Prishtinë.

Po ashtu, rëndësi e veçantë i është dhënë reklamimit në monitorët e vendosur në vagonët e udhëtarëve, në të cilët bëhet njoftimi i drejtpërdrejt për orarin e lëvizjes së trenit, promovimi i shërbimeve dhe dizajneve të ndryshme të krijuar nga Sektori i Marketingut.

#### *Aneks kontratat e nënshkruara me klientët vendorë gjatë vitit 2023:*

Nr.	Emri i kompanisë	Emri dhe Mbiemri	Përfaqësuesi	Vendi	Mallrat që transporton
1.	NewCo Ferronikeli	Cemil	Acar	Drenas	Xehe të nikelit dhe thëngjill.

*Gjatë vitit 2023 është nënshkruar vetëm një aneks kontratë, përkatësisht, me klientin kryesor NewCo Ferronikeli.*

#### *Kontratat e nënshkruara me partnerët ndërkombëtarë gjatë vitit 2023:*

Nr.	Emri i kompanisë	Emri dhe Mbiemri	Përfaqësuesi	Vendi	Mallrat që transporton
1.	NAVICO SHIPPING DOO	Zlatko Crvenkoski	JovanJovanovski	Shkup - Maqedoni	Të gjitha llojet
2.	CARGO LOGISTC DOO	Zoran Bakraceski	MarjanVeleviski	Shkup - Maqedoni	Të gjitha llojet
3.	SHENKER DOEL	Zoran Lazorovski	Tomislav Gjorceski	Shkup - Maqedoni	Të gjitha llojet
4.	FERSPED AD	Ivan Petrovski	Slavica Miseva	Shkup - Maqedoni	Të gjitha llojet
5.	ARGO LOGISTIC INT	Viktor Tatabitovski	Viktor Tatabitovski	Shkup - Maqedoni	Të gjitha llojet



*Klientët/Partnerët të cilët kanë nënshkruar kontratë transporti me Trainkos Sh.A. për vitin 2023 janë gjithsej katër (4). Duhet theksuar këta partnerë transporti janë ndërkombëtarë, me të cilët kemi pasur kontratë të nënshkruar edhe në vitin 2022, përjashtimisht klienti/partneri Schenker DB.*

*Sqarim: Klienti/partneri Shcenker DB nuk ka nënshkruar kontratë për vitin 2023 për shkak se Linja e Hanit të Elezit vazhdon të jetë e mbyllur, ndërsa Fershped AD nuk ka paguar garancionin bankar për shkak se nuk ka informatë të saktë për hapjen kësaj linje dhe rrjedhimisht kontrata e tij, sipas Rregullores së TM-së, nuk është e vlefshme deri në pagesën e garancionit.*

#### **VII.4. Raportimi i rregullt vjetor në Asociacionet tjera Hekurudhore dhe Sekretariatit për zbatimin e Traktatit për Transport**

Periudha raportuese ka rezultuar me veprime konkrete nga përgjegjësit e Sekretariatit për Zbatimin e Traktatit për Transport. Nga kontaktet, veprimet e ndodhura dhe pjesëmarrja në takime të organizuara kemi prezantuar gjendjen dhe nevojat e ndërmarrjes dhe kemi marrë njohuri për praktikat më të mira dhe proceset nëpër të cilat duhet të kalojë zhvillimi hekurudhor në vendin tonë.

Në periudhën raportuese është punuar në kompletimin e të dhënave të kërkuara nga Sekretariati që janë të domosdoshme në përfshirjen e raportit të progresit.

#### **VII.5. Shqyrtimi i mundësive për kryerjen e veprimtarisë – shpedicion për klientët e Trainkos-it**

Trainkos Sh.A. me Certifikatë të regjistrimit të biznesit ka të drejtë që përveç transportit me hekurudhë të ofrojë edhe shërbime tjera siç janë: Transport tjetër i rregullt tokësor i udhëtarëve, konstruktiv dhe riparim të mjeteve lëvizëse hekurudhore, transport tokësor rrugor të udhëtarëve, transporti rrugor të mallrave, transport detar dhe bregdetar, transport në rrugët e brendshme, ngarkim – shkarkim të peshave, magazinim të mallit, veprimtari të tjera përcjellëse të transportit tokësor dhe veprimtari të agjencive të tjera të transportit. Zhvillimi i aktivitetit të shpedicionit që nga ndarja e Hekurudhave të Kosovës (viti 2011) ka mbetur në fazën e përgatitjes së proceseve fillestare të zhvillimit të veprimtarisë dhe pret pëlqimin e stafit menaxhues dhe aprovimin nga Bordi i Drejtorëve për të filluar me këtë veprimtari. Duhet të kemi parasysh se përfshirja e kësaj veprimtarie në shërbimet që ofron Trainkos-i do të mundësonte një qasje më të kompletuar në raport me klientët ekzistues dhe klientët e ri potencialë në të ardhmen për transportin e mallrave dhe udhëtarëve.

## VII.6. Sfidat kryesore gjatë vitit 2023 dhe veprimet për të ardhmen

Gjatë periudhës raportuese, ndërmarrja vazhdon të ballafaqohet me sfidat si në vijim:

1. Ballafaqimi në vazhdimësi me ndërprerje të linjës Fushë Kosovë – Hani i Elezit gjatë Modernizimit të këtij sesioni. Vonesat në realizimin e projektit “Modernizimi i Linjës së 10-të hekurudhore” si infrastrukturë bazë që bën lidhjen me pjesën tjetër të Evropës dhe porte detare;
2. Gjendja jo e mirë e mjeteve lëvizëse për shkak të vjetërisë së tyre dhe nevoja për mjete lëvizëse adekuate për plotësimin e kërkesave për transportin e mallrave dhe udhëtarëve;
3. Restriksionet e vendosura nga Maqedonia Veriore për transport në minimum të 6 (gjashtë) vagonëve që vijnë në drejtim të Kosovës;
4. Mungesa e ligjit për sigurinë në komunikacionin hekurudhor;
5. Mos ndryshimi/amandamenti i Ligjit për Hekurudhat;
6. Proceset e shumta gjyqësore të trashëguara nga ish-Hekurudhat e Kosovës;
7. Mos funksionimi i të gjitha linjave hekurudhore;
8. Mos zbatimi i bazës ligjore dhe mungesa e legjislacionit sekondar në sektorin e transportit dhe lejimi i konkurrencës jolojale;
9. Licencimi dhe futja në treg e operatorit hekurudhor privat, pa ndonjë analizë të mirëfilltë të tregut nga ana e institucioneve relevante dhe rreziku i regjistrimit të pretenduesve tjerë;
10. Neglizhenca e institucioneve relevante të cilat veprojnë në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës në inkorporimin e operatorit shtetëror në planifikimet strategjike për zhvillim industrial të vendit;
11. Mosha mesatare e lartë e personelit ekzekutiv, nevoja për staf të kualifikuar që mund të përcjell trendin e zhvillimit të reformave/zhvillimeve në sektor.

Duke pasur parasysh që sfidat e lartcekura janë të natyrave të ndryshme dhe kërkojnë përkrahje edhe nga shumë institucione relevante, ndërmarrja është munduar në vazhdimësi që këto sfida t'i paraqes dhe të kërkojë zgjidhje/mbështetje. Por, ka qenë e pamundur arritja e rezultateve pozitive, duke rezultuar edhe me mos përmirësimin e përgjithshëm të gjendjes në ndërmarrje.

Përkushtimi i ndërmarrjes do të vazhdoj dhe do të insistohet që të gjitha këto sfida të trajtohen nga institucionet dhe faktorët tjerë relevant, në mënyrë që të marrin zgjidhjet e duhura, me qëllim të zhvillimit të ndërmarrjes si aset shtetëror.


Për këto sfida të precizuara më lart, përgjegjësit në Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh.A. sipas planifikimeve mbesin të përkushtuar në angazhimin maksimal në realizimin e objektivave të parapara duke treguar përkushtimin në angazhimet e mëtejme për të avancuar format e planifikimit në periudhat që na presin sipas ndryshimeve/planifikimeve shtetërore për transportin përmes hekurudhës.

## VIII. STRUKTURA ORGANIZATIVE

**Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh.A.** brenda periudhës janar – dhjetor 2023 në numrin e përgjithshëm të të punësuarve ka pasur disa ndryshime, të cilat kanë reflektuar edhe në përqindjen e strukturës së përgjithshme të të punësuarve.

Në të dhënat në vijim të këtij raporti do të pasqyrohet struktura organizative e ndërmarrjes dhe sistemimi i punëtorëve, duke filluar nga numri i përgjithshëm i të punësuarve, mosha mesatare, punëtorët me kontrata në kohë të caktuar dhe të pacaktuar etj.

**Skema organizative:**



Paraqitja statistikore për llojet e kontratave, mosha e të punësuarve, struktura gjinore, struktura nacionale dhe kualifikimi shkollor i të punësuarve në HK-Trainkos Sh.A. është paraqitur në tabelën si në vijim:

Struktura e të punësuarve në bazë të kategorizimeve të HK-Trainkos Sh.A. më 1 janar 2023 dhe më 31 dhjetor 2023					
Totali i numrit të punëtorëve	01.01.2023		31.12.2023		
	211		193		
Vlerat	Vlerat në numra		Vlerat në përqindje		
Datat	01.01.2023	31.12.2023	01.01.2023	31.03.2023	
Mosha mesatare e punëtorëve	47.06	48.21	%	%	
Në marrëdhënie të rregullt pune	211	193	%	%	
Me kontratë në kohë të pacaktuar	53	52	25.11%	26.94%	Format e kontratave
Me kontratë në kohë të caktuar	158	141	74.88 %	73.05%	
Meshkuj	184	167	87.20 %	86.52%	Gjinia
Femra	27	26	12.79 %	13.47 %	
Serb	2	1	0.94 %	0.51%	Nacion- aliteti.
Shqiptar	209	192	99.05 %	99.48%	
Me shkollim fillor	5	4	2.36%	2.07%	Shkollimi
Me PM (përgatitje të mesme) shkollore	113	107	53.55 %	55.44%	
Kualifikim profesional	22	20	10.42 %	10.36%	
Me përgatitje të lartë	2	2	0.94 %	1.03%	
Me përgatitje superiore	69	60	32.70 %	31.08%	
Zyrtarët e Lartë	5	4	2.36 %	2.07%	Përshkrimi i Departamenteve
Departamenti i Transportit të Mallrave	46	44	21.80 %	22.79%	
Departamenti i Transportit të Udhëtarëve	56	51	26.54 %	26.42%	
Departamenti i Administratës	46	40	21.80 %	20.72%	
Departamenti i Financave	7	7	3.31 %	3.62%	
Departamenti i Zhvillimit	5	5	2.36 %	2.59%	
Departamenti i Prokurimit	4	4	1.89 %	2.07%	
Kabineti i KE-së	2	2	0.94%	1.03%	Kabineti i KE-së dhe Zyrat në kuadër të KE-së
Zyra e Kontrollit, Sigurisë dhe Kualitetit	19	15	9.00 %	7.77%	
Zyra për Marrëdhënie me Publikun	1	1	0.47 %	0.51%	
Zyra Ligjore	3	3	1.42 %	1.55%	
Zyra e Mirëmbajtjes	17	17	8.05 %	8.80%	

Në bazë të të dhënave në tabelën më lart, shihet se numri i përgjithshëm i punëtorëve me datën 01.01.2023 ka qenë 211, ndërsa me datën 31.12.2023 ka qenë 193 punëtorë.

**Vërejtje:** Në tabelën më lart nuk janë përfshirë anëtarët e Bordit të Drejtoreve.

## IX. PROCEDURAT GJYQËSORE

### IX.1. Kontestet gjyqësore

Gjatë vitit 2023, nga Zyra Ligjore e Ndërmarrjes janë marrë të gjitha veprimet e nevojshme për përfaqësim sa më të mirë në çështjet ligjore pranë të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës. Gjatë vitit 2023, pranë gjykatave themelore kanë qenë të caktuara 9 seanca gjyqësore për proceset në të cilat ndërmarrja ka qenë palë në procedurë, qoftë në cilësinë e të paditurës apo të paditëses.

Gjatë këtij viti, ndërmarrja në procedurë gjyqësore është përballur dhe ka zhvilluar veprime procedurale në 26 konteste për kompensim dëmi, 4 konteste për pagim borxhi, 10 konteste të punës dhe 19 konteste në procedurë përmbartimore. Ndërsa, 1 lëndë nga Gjykata Penale ka përfunduar në procedurë përmbartimore dhe për 1 lëndë përmbartimore, ndërmarrja ka pranuar aktvendim të Gjykatës Themelore.

Gjithsej 10 lëndë janë pranuar me aktvendim të Gjykatës Themelore, 4 aktgjykime janë nga Gjykata e Apelit, 3 aktgjykime janë nga Gjykata Supreme, 2 aktvendime janë nga Gjykata Komerciale, ndërsa 2 aktgjykime janë po ashtu nga Gjykata Komerciale.

Nga HK-Trainkos janë bërë 2 padi për pasurim të pabazë në Gjykatën Themelore, 2 përgjigje në padi në Gjykatën Themelore si dhe 1 ankesë në padi. Është pranuar 1 ekspertizë dhe është bërë kundërshtimi i saj, ndërsa 1 ankesë është ushtruar tek Gjykata Themelore për Gjykatën e Apelit.

Në vitin 2023 nga Gjykata Supreme e Kosovës është pranuar Aktgjykim në favor të ndërmarrjes në lëndën kontest pune Rev.nr.234/2022, vlera: 49,895.12€ paditës: Hysni Tolaj.

### IX.2. Rreziqet nga kontestet gjyqësore për vitin 2024

Në tabelën më poshtë është pasqyruar numri i kontesteve dhe kategorizimi i tyre për të cilat mund të zhvillohen veprime procedurale gjatë vitit 2024:

Nr.	LLOJET E KONTESTEVE	Nr.
1.	Kontestet e marrëdhënies së punës	8
2.	Kontestet për kompensim të dëmit	25
3.	Kontestet për pagimin e borxhit	4
4.	Kontestet nga Konflikti Administrativ	1
5.	Lëndë në procedurë përmbartimore	18
6.	Lëndë në procedurë penale	1
	<b>Totali</b>	<b>57</b>

Tabela 9.1

Sipas të dhënave në tabelën më lart, Hekurudhat e Kosovës-Trainkos Sh.A. gjatë vitit 2024 pritet që të ballafaqohen me 57 konteste gjyqësore. Dinamika e rasteve gjyqësore dhe zhvillimi i tyre natyrisht që përcaktohet nga ana e gjykatave, mirëpo gjithsesi se përgatitjet e nevojshme, monitorimi i afateve dhe të gjitha veprimeve tjera janë marrë me kohë nga 9 rastet e zhvilluara në gjykatë gjatë vitit.

## X. PËRFUNDIM

HK-Trainkos Sh.A gjatë vitit 2023, përkundër përpjekjeve e angazhimit, nuk ka arritur që të përmbush planifikimet dhe objektivat e përcaktuara në Planin e Biznesit për këtë vit. Pengesat kanë qenë nga më të ndryshmet, probleme të vjetra e të shumta janë bërë pengesë në realizimin e planifikimeve dhe në zhvillimin e ndërmarrjes.

Megjithatë, përkundër të gjitha vështirësive, disa prej sukseseve të arritura nga masat e ndërmarrja gjatë këtij viti janë premtuese për ndërmarrjen, të domosdoshme po ashtu kanë qenë për tejkalimin e gjendjes së vështirë të saj. Shkurtime të buxhetore dhe shfrytëzimi racional i resurseve tjera të ndërmarrjes, kanë ndikuar në shkallë të lartë në sanimin e gjendjes dhe zvogëlimin e humbjeve në vitin 2023.

Pengesat që janë shfaqur nga realizimi i projektit në rehabilitimin e Linjës së 10-të Hekurudhore pothuajse janë afër tejkalimit, këtë vit presim që Linja e Hanit të Elezit të jetë e gatshme për operim. Me fillimin e transportit hekurudhor në këtë linjë për Trainkos-in do të hapen mundësi të reja, por njëkohësisht do të shtohen edhe sfidat.

Gjendja e mjeteve lëvizëse hekurudhore të ndërmarrjes, të cilat janë të vjetruara e të pakta në numër, padyshim që rrisin kërkesën dhe nevojën për ripërtëritjen e tyre. Procesi i avancimeve në sistemin hekurudhor me planifikimet strategjike për kontinentin nga BE-ja për funksionalizimin e tërë Rrjetit Bazik Hekurudhor të Evropës dhe kërkesat që vijnë nga nevoja për reformim të këtij sistemi në Evropën Juglindore kërkojnë përgatitje adekuatë për ndërmarrjen, përfshirë edhe mjete lëvizëse hekurudhore sipas standardeve. Plotësimi i kriterëve të Interoperabilitetit përmes TSI dhe plotësimi i kriterëve/kërkesave që vijnë përmes Planit të Veprimit për Mekanizmin Stabilizim Asociim (PVMSA) dhe kërkesat tjera që Trainkos-i duhet t'i plotësojë si pjesë përbërëse e sistemit hekurudhor të Republikës së Kosovës është dhe do të jetë sfiduese.

Besojmë se me mbështetjen edhe të Aksionarit, do të gjejmë rrugë e mundësi për investime në mjetet lëvizëse, qoftë përmes granteve apo investimeve përmes formave tjera të financimit nga institucionet financiare.

Përkushtimi i përhershëm mbetet në angazhimet tona të përditshme për zhvillimin e mëtutjeshëm të ndërmarrjes në ofrimin sa më të mirë të shërbimeve tona për klientët tanë.

Fushë Kosovë,

Shkurt 2023

Agron Statovci  
U. D. Kryeshf Ekzekutiv

